



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

# REPUBLIKA E KOSOVËS

## PROFILI I LEHTË I MIGRIMIT

2021

AUTORITETI QEVERTAR PËR MIGRIM

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara dhe i takojnë Autoritetit Qeveritar për Migrim - Qeveria e Republikës së Kosovës. Riprodhimi nuk është i lejuar pa autorizim. Në rast të përdorimit të të dhënave nga ky dokument, duhet cituar burimin.

*Kontakti:*

Autoriteti Qeveritar për Migrim  
Qeveria e Republikës së Kosovës  
Ministria e Punëve të Brendshme  
Tel: + 383 (0) 38 200 19 545  
[www.mpb.rks-gov.net](http://www.mpb.rks-gov.net)  
Adresa: Rruga "Luan Haradinaj" 14  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

## Qëllimi i Profilit të Lehtë të Migrimit për vitin 2021

Qëllimi i këtij dokumenti është të ofrojë një pasqyrë të zhvillimeve në fushën e migrimit (imigrimit dhe emigrimit) për institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile, organizatat jo-qeveritare, komunitetin akademik/hulumtues, si dhe për palët e tjera të interesit. Dokumenti përmban analiza bazuar në statistika dhe evidencë dhe përfundon me rekomandime të cilat mund t'i shërbejnë mekanizmave vendimmarrës, me qëllim të përfshirjes së tyre në politika shtetërore dhe sektoriale që ndërlidhen me çështjet e migrimit dhe të zhvillimit socio-ekonomik të vendit.

Ky dokument pasqyron zhvillimet dhe ndryshimet në politika, legjislacion dhe ato institucionale që kanë ndodhur gjatë vitit 2021, ndërsa në pjesët e dokumentit ku nuk ka pasur zhvillime apo ndryshime, teksti ka mbetur i pandryshuar.

Analiza e trendëve të migrimit e prezantuar në këtë dokument mbulon periudhën 3-vjeçare nga viti 2019 deri në 2021, e paraqitur përmes figurave dhe tabelave, ku përfshihen potencialisht edhe periudhat paraprake në rast të ndonjë ndryshimi të dukshëm të trendeve migruese. Të dhënat administrative dhe statistikore të përdorur në këtë dokument, janë burim i sistemeve informative ekzistuese të institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe burimet evropiane dhe ndërkombëtare.

Struktura e dokumentit përfshin zhvillimet e politikave dhe legjislacionit, zhvillimet institucionale, si dhe analizën e të dhënave statistikore që ndërlidhen me fushën e migrimit.

Profili i Lehtë i Migrimit për vitin 2021 është hartuar nga ekspertë dhe zyrtarë të institucioneve të Republikës së Kosovës, të cilët njëherësh janë anëtarë të Autoritetit Qeveritar për Migrim.

# PËRMBAJTJA

Qëllimi i Profilit të Lehtë të Migrimit për vitin 2021 .....	2
Shkurtesat .....	5
1. Informata të Përgjithshme për Shtetin .....	7
1.1. Popullsia, madhësia, vendet fqinje dhe gjatësia e kufijve .....	7
1.2. Përmbledhje e veçorive për vendin .....	9
2. Rrjedhat e Përgjithshme të Migrimit dhe Stoqet e Migrimit .....	11
2.1. Rrjedhat e Migrimit .....	11
3. Migrimi i rregullt me fokus të veçantë në migrimin e fuqisë punëtore .....	16
3.1. Autoritetet Shtetërore Përgjegjëse .....	16
3.2. Shërbimet e Migrimit për Çështje të Punësimit .....	17
3.3. Politikat dhe Korniza Ligjore .....	17
3.4. Statistikat .....	18
4. Migrimi i Parregullt .....	24
4.1. Autoritetet Shtetërore Përgjegjëse .....	24
4.2. Politikat dhe Korniza Ligjore .....	25
4.3. Statistikat .....	25
5. Kthimi, Ripranimi dhe Riintegrimi .....	36
5.1. Kthimi i të Huajve .....	36
5.1.1. Autoritetet Shtetërore Përgjegjëse .....	36
5.1.2. Politikat dhe Korniza Ligjore .....	36
5.1.3. Statistikat .....	36
5.2. Ripranimi .....	39
5.2.1. Autoritetet Shtetërore Përgjegjëse .....	39

5.2.2. Politikat dhe Korniza Ligjore .....	39
5.2.3. Statistikat.....	40
5.3. Riintegrimi .....	42
5.3.1. Autoritetet Shtetërore Përgjegjëse .....	42
5.3.2. Politikat dhe Korniza Ligjore .....	42
5.3.3. Statistikat.....	43
6. Integrimi i të Huajve.....	46
6.1. Autoritetet Shtetërore Përgjegjëse .....	46
6.2. Politikat dhe Korniza Ligjore .....	46
6.3. Statistikat.....	48
<b>7. Migrimi dhe Zhvillimi.....</b>	<b>50</b>
7.1. Autoritetet Shtetërore Përgjegjëse .....	50
7.2. Politikat dhe Korniza Ligjore .....	52
7.3. Statistikat.....	57
8. Azili.....	61
8.1. Autoritetet Shtetërore Përgjegjëse .....	61
8.2. Politikat dhe Korniza Ligjore .....	61
8.3. Statistikat.....	62
9. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET .....	67
9.1. Përfundimet .....	67
9.2. Rekomandimet .....	68

## Shkurtesat

Shkurtesat	Përshkrimi
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
AQM	Autoriteti Qeveritar për Migrim
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CPRK	Programi për të Drejtat Civile/Kosovë
DDE	Departamenti i Diplomacisë Ekonomike
DMH	Drejtoria për Migrim dhe të Huaj
DRPRIH	Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimi i të Huajve
DSHAM	Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim
DHKO	Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar
DHTQNJ	Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore
EUROSTAT	Zyra e Statistikave të Bashkimit Evropian
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnimin e Hetimeve Kriminale
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
IOM/ ONM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
JRS	Shërbimi Jezuit për Refugjatë
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
KKR	Komisioni Kombëtar për Refugjatë
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MIMAK	Projekt 'Fuqizimi i Autoriteteve në Kosovë për Menaxhim të Migrimit'
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MM	Memorandum i Mirëkuptimit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MSH	Ministria e Shëndetësisë
ME	Ministria e Ekonomisë
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PK	Policia e Kosovës

<b>PKK</b>	Pika e Kalimit Kufitar
<b>PRE</b>	Programi i Reformave në Ekonomi
<b>QRK</b>	Qeveria e Republikës së Kosovës
<b>RKS</b>	Republika e Kosovës
<b>SKZH</b>	Srategjia Kombëtare Zhvillimore
<b>SHBA</b>	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
<b>UNHCR</b>	Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
<b>UNICEF</b>	Fondi Ndërkombëtar i Emergjencës për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara

# 1. Informata të Përgjithshme për Shtetin

## 1.1. Popullsia, madhësia, vendet fqinje dhe gjatësia e kufijve

Republika e Kosovës është shteti më i ri në Gadishullin Ballkanik me një pozicion gjeografik qendror e rrethuar me Republikën e Shqipërisë, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Republikën e Malit të Zi dhe Republikën e Serbisë.



**Rajoni:** Evropa Juglindore

**Gjerësia e territorit të Kosovës:** 41° 51' 21 dhe 43° 16'

**Gjatësia e territorit të Kosovës:** 19° 59' dhe 21° 47'

**Emri zyrtar:** Republika e Kosovës

**Kryeqyteti:** Prishtina

**Gjatësia e kufijve:** Me Republikën e Shqipërisë në jugperëndim 113.551 km, me Republikën e Maqedonisë së Veriut në jug 170.772 km, me Republikën e Malit të Zi në veriperëndim 79.165 km, me Republikën e Serbisë në verilindje 380.068 km. Kufiri i Republikës së Kosovës me vendet fqinje kryesisht kalon nëpër male dhe ka karakter natyror, kurse gjatësia e përgjithshme e kufirit është 743.556 km<sup>1</sup>.

**Sipërfaqja<sup>2</sup>:** 10,908 km<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2020-2025  
<https://mpb.rksgov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/364/Strategjia%202020-2025.pdf>

<sup>2</sup> Po aty



**Vendet fqinje:** Republika e Shqipërisë, Republika e Maqedonisë së Veriut, Mali i Zi, Republika e Serbisë.

**Popullsia:** 1,773.971 (e vlerësuar më 1 janar 2022)

**Dendësia e popullsisë:** 163 banorë për 1 km<sup>2</sup>

**Forma e qeverisjes:** Republikë Parlamentare

**Valuta:** Euro (EUR)

**Dita e pavarësisë:** 17 shkurt 2008

**President:** Znj. Vjosa Osmani

## 1.2. Përmbledhje e veçorive për vendin

Republika e Kosovës është shtet i së drejtës me demokraci parlamentare i bazuar mbi parimin e ndarjes së pushteteve në atë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ. Qeveria e Republikës së Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv dhe është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe politikave shtetërore. Shtylla e tretë është pushteti gjyqësor, i cili është i pavarur, unik dhe ushtrohet nga gjykatat. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit.

Kompetencat administrative në fushën e migrimit dhe azilit ndërthuren në mes të nivelit qendror dhe atij lokal (komunal).

Sistemi për menaxhimin e migrimit në Kosovë është i rregulluar përmes kornizës ligjore<sup>3</sup> dhe asaj institucionale. Ministria e Punëve të Brendshme është institucion përgjegjës i cili adreson çështjet e azilit, të huajve, shtetësisë, ripranimit, migrimit të parregullt, si dhe çështjet e riintegrimit të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve me qëndrim në Republikën e Kosovës. Institucionet e tjera që kanë përgjegjësi në çështjet e migrimit janë: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Zyra e Kryeministrit/Zyra për Integrim Evropian (ZKM), Ministria e Ekonomisë (ME), Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Policia e Kosovës (PK), si dhe Banka Qendrore e Kosovës (BQK).<sup>4</sup>

---

<sup>3</sup> Ligji Nr.04/L-219 për të Huajt, Ligji Nr.06/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, Ligji Nr.06/L-026 për Azil, Ligji Nr.04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës, Ligji Nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, Ligji Nr.04/L-214 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, Ligji Nr.06/L-013 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, Ligji Nr.04/L-216 për Bashkëpunim Ndërmjet Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit, Ligji Nr.04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, Ligji Nr.03/L-208 për Ripranim, Ligji Nr.04/L-076 për Policinë, Ligji Nr.04/L-003 për Gjendjen Civile, Ligji Nr.04/L-205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, Rregullorja (QRK) Nr. 13/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë e Punësimit.

<sup>4</sup> Rregullorja (QRK)-Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.

**Autoriteti Qeveritar për Migrim (AQM)**, i themeluar me Vendim<sup>5</sup> të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është përgjegjës për monitorimin e lëvizjeve migruese dhe funksionon si mekanizëm ndërinstitucional duke përfshirë të gjithë akterët relevantë në fushën e migrimit. AQM-ja është përgjegjëse për hartimin e profileve të migrimit dhe u jep rekomandime autoriteteve shtetërore në fushën e migrimit, si dhe propozon politika të reja në këtë fushë për Qeverinë.

Gjatë vitit 2021 është miratuar Rregullorja (QRK)-Nr. 02/2021<sup>6</sup> (plotësuar/ndryshuar me Rregulloren (QRK)-Nr. 04/2021)<sup>7</sup> për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive. Me Rregulloren QRK-Nr. 02/2021 është shfuqizuar: Rregullorja (QRK)-Nr. 06/2020 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK)-Nr. 07/2020.

Në aspektin e zhvillimeve strategjike është hartuar dhe miratuar Strategjia për Migrim 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2021-2023 (e miratuar me Vendimin e Qeverisë 10/39, më datë 13.10.2021). Kjo strategji përmban katër objektiva strategjike si dhe masa konkrete lidhur me menaxhimin e migrimit, parandalimin e migrimit të parregullt, avancimin e sistemit të migrimit të brendshëm, si dhe avancimin e qeverisjes së migrimit. Kjo strategji është në harmoni me objektivat e Paktit Global për Migrim, Paktin Global për Refugjatë, si dhe Paktin e BE-së për Azil dhe Migrim.<sup>8</sup>

---

<sup>5</sup> Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 08/158, i datës 29 nëntor 2013 për themelimin e Autoritetit Qeveritar për Monitorimin e Lëvizjeve të Migrimit.

<sup>6</sup> Rregullorja (QRK)-Nr. 02/2021<sup>6</sup> (plotësuar/ndryshuar me Rregulloren (QRK)-Nr. 04/2021)<sup>6</sup> për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=39317>

<sup>7</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=47884->

<sup>8</sup> <https://mpb.rks.gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/47/STRATEGJIA%20KOMB%C3%8BTARE%20KUND%C3%8BR%20TRAFIKIMIT%20ME%20NJER%C3%8BZ%20N%C3%8B%20KOSOV%C3%8B%202015-2019.pdf>

## 2. Rrjedhat e Përgjithshme të Migrimit dhe Stoqet e Migrimit


Popullsia rezidente në Kosovë në fund të vitit 2021 (1 janar 2022) është vlerësuar të jetë 1,773.971 banorë. Agjencia e Statistikës së Kosovës (ASK) çdo vit bën vlerësimin e numrit të popullsisë, duke përfshirë të dhënat për migrimin, me përdorimin e metodologjisë së standardizuar me qëllim të gjithë përfshirjes së të gjitha grupeve të migrimit.

### 2.1. Rrjedhat e Migrimit

#### 2.1.1. Imigrimi

Sipas vlerësimit të ASK-së gjatë vitit 2021, pjesëmarrja e imigrantëve në popullsinë e përgjithshme rezidente ishte 0.23% apo 4,122 persona<sup>9</sup> Në këtë shifër janë përfshirë të gjitha kategoritë e imigrantëve (shtetas kosovarë të kthyer/ripranuar dhe të huaj) pa marrë parasysh arsyen e imigrimit.

Figura 1: Imigrimi në Kosovë sipas viteve, 2019-2021



Burimi: ASK


<sup>9</sup> Vlerësim, Popullsia e Kosovës 2021, faqe 12 tabela 2: Prishtinë, Qershor 2022: <https://ask.rks-gov.net/media/6105/vler%C3%ABsimi-i-popullsis%C3%AB-2020.pdf>

Për periudhën 2019-2021, të dhënat tregojnë se një numër i konsiderueshëm i personave që kanë imigruar gjatë këtyre viteve janë shtetas kosovarë (migrantë të kthyer/ripranuar) dhe të huaj, me një mesatare vjetore prej 7,243 personave apo 0.40% e popullsisë së përgjithshme rezidente brenda një viti.

### 2.1.2. Emigrimi

Numri i emigrantëve kosovarë gjatë vitit 2021, i vlerësuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës ishte gjithsej 42,728 persona<sup>10</sup> apo 2.4% e popullsisë rezidente. Në këtë numër janë përfshirë të gjithë emigrantët pa marrë parasysh arsyen e migrimit dhe statusin e tyre (rregullt dhe parregullt).

Figura 2: Emigrimi nga Kosova i vlerësuar nga ASK-ja sipas viteve, 2019-2021



Burimi: ASK

Të dhënat për periudhën 2019-2021 tregojnë se Kosova vazhdon të ketë shkallë të lartë të emigrimit me një mesatare vjetore prej 28,787 personave apo 1.62% të popullatës kosovare.

<sup>10</sup> Vlerësim, Popullsia e Kosovës 2021, faqe 12 tabela 2: Prishtinë, Qershor 2022  
<https://ask.rks-gov.net/media/6105/vler%C3%ABsimi-i-popullsis%C3%AB-2020.pdf>

### 2.1.3. Migrimi Neto

Bilanci i migrimit ndërkombëtar (migrimi neto) në Kosovë për vitin 2021 ishte 38,606 banorë apo 2.18% e popullsisë rezidente. Për periudhën 2019-2021 vlerësohet se nga Kosova janë larguar 86,363 banorë apo rreth 4.86% e popullsisë së vendit.

Tabela 1: Rrjedhat e migrimit: imigrimi, emigrimi dhe migrimi neto për vitet 2019-2021

Vitet	Imigrimi	Emigrimi	Net migrimi (nr. absolut)	Net migrimi (përqindje)
2019	6,066	34,911	-28,845	-1.62
2020	11,543	8,724	2,819	0.16
2021	4,122	42,728	-38,606	-2.18

Burimi: ASK<sup>11</sup>

## 2.2. Stoqet e Migrimit

### 2.2.1. Stoqet e Imigrimit

Nëse e krahasojmë vitin 2021 me 2020 kemi rritje për rreth 5% të imigrantëve.

<sup>11</sup> Vlerësim, Popullsia e Kosovës 2020, faqe 9 tabela 2: Prishtinë, Qershor 2021: <https://ask.rks-gov.net/media/6105/vler%C3%ABsimi-i-popullsis%C3%AB-2020.pdf>

Tabela 2: Stoqet e imigrimit dhe rrjedhat e imigrimit të shprehura në numra absolutë dhe relativë, 2019-2021

Viti	Gjithsej popullsia	Stoku i imigrimit (numra absolutë)	Stoku (përqindje)
2019	1,782,115	66,738	3.74
2020	1,798,188	78,281	4.35
2021	1,773,971	82,403	4.65

Burimi: ASK

### 2.2.2. Stoqet e Emigrimit

Tabela 3: Stoqet e emigrimit dhe rrjedha e emigrimit të shprehura në numra absolutë dhe relativë, 2019-2021

Viti	Gjithsej popullsia	Stoku i emigrimit (numra absolutë)	Stoku (përqindje)
2019	1,782,115	245,081	13.75
2020	1,798,188	253,805	14.11
2021	1,773,791	296,533	16.70

Burimi: ASK

### 2.2.3. Stoku i Migrimit Neto

Gjatë periudhës 2019-2021, në Kosovë imigruan mbi 21,731 banorë, ndërsa emigruan mbi 86,363 banorë dhe popullata e Kosovës gjatë kësaj periudhe është zvogëluar për më shumë se 64,632 banorë.

Tabela 4: Stoqet e migrimit neto të shprehura në numra absolutë dhe relativë, 2019-2021

Viti	Gjithsej popullsia	Rrjedhat e imigrimit (numra absolutë)	Rrjedhat e emigrimit (numra absolutë)	Rrjedhat neto të emigrimit, sipas viteve	Stoku neto i migrimit (numra absolutë)	Stoku neto (në raport me shpërndarjen e popullsisë)
2019	1,782,115	6,066	34,911	-28,845	883,043	49.55
2020	1,798,188	11,543	8,724	2,819	885,862	49.26
2021	1,773,971	4,122	42,728	-38,606	847,256	47.8

Burim: ASK

Nëse merret si bazë popullsia që jetonte jashtë vendit më 1 prill 2011 (703,978 banorë vlerësohet se jetonin jashtë vendit) në fund të vitit 2021, vlerësohet se mbi 847,256 banorë apo 47.8% e popullsisë së Kosovës jetonte jashtë vendit.



### 3. Migrimi i rregullt me fokus të veçantë në migrimin e fuqisë punëtore

Ky kapitull përmban informacione të nevojshme rreth të dhënave dhe shërbimeve të këshillimit lidhur me menaxhimin e migrimit të rregullt, me fokus të veçantë në migrimin e fuqisë punëtore. Politikat që ndërlidhen me menaxhimin e migrimit të rregullt janë përgjegjësi e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) / Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK).<sup>12</sup>

#### 3.1. Autoritetet Shtetërore Përgjegjëse

Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Divizioni për të Huajt në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM), është autoriteti shtetëror përgjegjës për pranimin, shqyrtimin dhe vendimmarrjen lidhur me kërkesat për pajisje me lejet e qëndrimit të përkohshëm (përfshirë edhe lejet e qëndrimit me qëllim punësimi), dhe të përhershëm në Republikën e Kosovës. Në kuadër të reformave institucionale për ofrimin e shërbimeve për të huajt, gjatë vitit 2021 është aktivizuar platforma E-Kosova për aplikim për lejqëndrime nga të huajt në Divizionin për të Huajt, e cila do të ndikojë në digjitalizimin e tërë procesit të aplikimit e deri tek vendimmarrja. Në bazë të Ligjit për të Huajt<sup>13</sup>, Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK)<sup>14</sup> lëshon leje pune afatshkurtër për të huajt, me kohëzgjatje maksimale prej 90 ditëve, brenda një periudhe kohore prej 180 ditëve, gjatë një viti. APRK-ja është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe trajnimeve profesionale për të huajt, të cilët kanë qasje në tregun e punës në Republikën e Kosovës. APRK-ja gjithashtu ofron informacione, shërbime këshillimi dhe orientim në karrierë, zhvillim të shkathtësive profesionale dhe ndërmjetësim të punësimit për punëkërkuesit kosovarë të cilët synojnë tregun e punës jashtë vendit.

---

<sup>12</sup> Rregullore (QRK) - Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (rks-gov.net).

<sup>13</sup> Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huajt dhe Ligji Nr. 03/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt.

<sup>14</sup> Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës.

### 3.2. Shërbimet e Migrimit për Çështje të Punësimit

Gjatë vitit 2021, Divizioni i Shërbimeve të Migrimit në kuadër të APRK-së, përmes trajnimeve dhe kurseve të ndryshme ka ndërmarrë masa në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve (këshilltarëve për shërbime të punësimit, duke përfshirë shërbimet e migrimit), në bashkëpunim me Autoritetin Qeveritar për Migrim (AQM-në), projektin MIMAK, GIZ-in dhe Qendrën Informuese Gjermane për Migrim, Aftësim Profesional dhe Karrierë (DIMAK).

Gjatë vitit 2021, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës ka vazhduar me implementimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit për Mobilitet në Punë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë, e cila marrëveshje është arritur gjatë vitit 2020, ku qëllimi i këtij bashkëpunimi ishte përforcimi i marrëdhënieve mes agjencive zbatuese të politikave të punësimit dhe aftësimit profesional me qëllim shkëmbimin e praktikave më të mira dhe mundësinë e punësimit të punëtorëve nga secili shtet në territorin e shtetit tjetër.

### 3.3. Politikat dhe Korniza Ligjore

Migrimi i rregullt (imigrimi) në Republikën e Kosovës, duke përfshirë imigrimin për qëllime punësimi është i rregulluar me Ligjin për të Huaj<sup>15</sup> dhe aktet tjera nënligjore.

Gjatë vitit 2021, nuk ka pasur zhvillime në kontekst të hartimit të politikave dhe legjislacionit që ndërlidhet me migrimin e rregullt, në veçanti lidhur me migrimin për qëllime punësimi. Megjithatë, në Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2021 është miratuar akti nënligjor si në vijm:

- Koncept dokumenti i Ligjit Nr.04/L-219 për të Huaj dhe Ligji Nr.06/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-219 për të Huaj, është miratuar në Qeveri me Vendimin Nr.18/52 të datës 29.12.2021.

---

<sup>15</sup> Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huaj dhe Ligji Nr. 03/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huaj, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16333>

## 3.4. Statistikat

### 3.4.1. Imigrimi i Rregullt

Që nga viti 2021, sistemi informativ i DSHAM-së është avancuar dhe ka filluar gjenerimin e të dhënave lidhur me lejeqëndrimet në dy kategori: 1) lejeqëndrimet për herë të parë, dhe 2) lejeqëndrimet në vazhdim.

Gjatë vitit 2021 janë lëshuar gjithsej 4,281 vendime pozitive për lejeqëndrime të përkohshme prej tyre:


- Lejeqëndrime për herë të parë 1,414 (33%) dhe
- Lejeqëndrime në vazhdim 2,867 (67%).

Nga numri i përgjithshëm i lejeqëndrimeve të përkohshme për të huaj, gjatë vitit 2021 nga të gjitha kategoritë ka pasur rritje prej 25% (4,281) krahasuar me vitin 2020 (3,436). Lejeqëndrime për qëllime punësimi janë lëshuar 2,121 (50%), për kategorinë e bashkimit familjar 1,863 (44%), për studim/shkollim 226 (5.3%) dhe për arsye të tjera 71 (1.6%) lejeqëndrimi të përkohshme.

Sipas gjinisë, nga numri i përgjithshëm i vendimeve pozitive për lejeqëndrim të përkohshëm (4,281), 2,489 (58%) janë të gjinisë femërore, kurse 1,792 (42%) janë të gjinisë mashkullore.

Numri i lejeve të qëndrimit të përkohshme të lëshuara sipas shteteve është si në vijim: Shqipëria me 1,203 (28%), Serbia me 936 (22%), Turqia me 692 (16%), Maqedonia e Veriut me 461 (11%), SHBA me 167 (4%) dhe shtete të tjera me 822 (19%).

Figura 3: Numri i lejeve të qëndrimit të përkohshëm me qëllim të punësimit sipas lejeqëndrimeve për herë të parë dhe në vazhdim, 2019-2021



Burimi: MPB/DSHAM

Numri i lejeve të qëndrimit të përkohshëm për arsye punësimi, gjatë vitit 2021 ka pasur një trend ngritjeje prej 19% krahasuar me vitin 2020. Në përgjithësi, faktorët që mund të kenë ndikuar në këtë rënie të punësimit të të huajve në Republikën e Kosovës për vitin 2020 dhe 2021, krahasuar me vitet paraprake mund të jenë të ndërlidhura masat e ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me menaxhimin e pandemisë me Covid-19, mbyllja e kufirit dhe kufizimi i lirisë së lëvizjes, si dhe me përfundimin e projekteve të kompanive të huaja.

Shtetet më të përfaqësuara me numrin e lejeve të qëndrimit të përkohshëm për arsye punësimi janë: Shqipëria me 543 (25.6%), Turqia me 431 (20.3%), Serbia me 339 (16%), Maqedonia e Veriut me 184 (8.6%), SHBA me 130 (9%) dhe shtetet e tjera me 492 (23.2%).

### 3.4.2. Lejet e Qëndrimit të Përhershëm

Gjatë vitit 2021 janë lëshuar gjithsej 230 vendime pozitive për lejqëndrim të përhershëm prej tyre:


- Lejqëndrime për herë të parë 48 (21%), dhe
- Lejqëndrime në vazhdim 182 (79%).

Nga numri i përgjithshëm i lejqëndrimeve të përhershme për të huaj, gjatë vitit 2021 nga të gjitha kategoritë ka pasur rritje prej 62% (230) krahasuar me vitin 2020 (142).

Sipas gjinisë, nga numri i përgjithshëm i vendimeve pozitive për lejqëndrim të përhershëm (230), 141 (61%) janë të gjinisë mashkullore, kurse 89 (39%) janë të gjinisë femërore.

Arsyet e lëshimit të lejeve të qëndrimit të përhershëm sipas kategorive janë si në vijim: punësim 96 (41.7%), bashkim familjar 62 (27%), dhe arsye të tjera 72 (31.3%).

Figura 4: Numri i lejeve të qëndrimit të përhershëm me qëllim të punësimit sipas vitit, 2019-2021




Burimi: MPB/DSHAM

Shtetet më të përfaqësuara me numrin e lejeve të qëndrimit të përhershëm për arsye punësimi janë: Maqedonia e Veriut 28 (30%), Serbia 20 (21%), Turqia 19 (20%), Shqipëria 17 (18%) dhe shtete të tjera 12 (12.5%).

### 3.4.3. Leje Pune Afatshkurta<sup>16</sup>

Gjatë vitit 2021 janë lëshuar 190 leje pune afatshkurta për shtetas të huaj, ku nga ky numër 23 leje pune afatshkurta kanë qenë vazhdim. Numri i lejeve të punës afatshkurtër për të huajt në vitin 2021 ka shënuar një rritje prej 94% krahasuar me vitin 2020, si rrjedhojë e lehtësimit të masave të pandemisë Covid-19. Numri i lejeve të punës afatshkurtra të dhëna sipas shteteve janë si në vijim: Poloni me 31, Maqedonia e Veriut me 24, Kroaci me 22, Greqi me 15, Bullgaria, Rumani dhe Spanja me ka 14, kurse shtetet tjera me rreth 56.

Figura 5: Numri i lejeve të punës afatshkurtër sipas vitit, 2019-2021



Burimi: MFPT/APRK

<sup>16</sup> Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huaj dhe Ligji Nr. 03/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huaj, neni 22, Leja e punës afatshkurtër deri në nëntëdhjetë (90) ditë brenda çdo periudhe prej njëqindetëdhjetë (180) ditëve brenda një (1) viti, mund të punojnë të huajt, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876>


### 3.4.4. Emigrimi i Rregullt

#### Shtetasit e Republikës së Kosovës me leje të vlefshme qëndrimi në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Shengen

Për shtetasit e Republikës së Kosovës, në fund të vitit 2021, janë lëshuar 23,467 leje qëndrimi të vlefshme të të gjitha kategorive në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen.<sup>17</sup> Numri i lejeve të vlefshme të qëndrimit të lëshuara, bazuar në të dhënat e Eurostat-it kishte rënie për 42% krahasuar me vitin 2020 (33,255).

Gjatë vitit 2021, 47.3% të të gjitha lejeve të qëndrimit ishin të lidhura me bashkim familjar, 40.6% për qëllim punësimi, 2% për qëllim të arsimimit, ndërsa leje qëndrime të klasifikuara për arsye të tjera përbënin 9.6% të të gjitha kategorive. Gjatë kësaj periudhe, me lejeqëndrime të vlefshme të shtetasve të Republikës së Kosovës destinacionet kryesore ishin Sllovenia me 7,058 (30%), Kroacia me 3,275 (14%) dhe Italia 2,356 (10%), kurse nën 10% shpërndarja ishte në shtetet tjera.

Figura 6: Emigrantët kosovarë në shtetet e BE-së dhe zonës Shengen, sipas arsyes së qëndrimit, 2019-2021



Burimi: Eurostat<sup>18</sup>

<sup>17</sup> Shënim: Gjermania ka raportuar 0 në Eurostat numrin e lejeqëndrimeve të lëshuar për shtetasit e Republikës së Kosovës


<sup>18</sup> <https://ec.europa.eu/eurostat/web/asylum-and-managed-migration/data/database>

### 3.4.5. Lirimi i Shtetësisë së Republikës së Kosovës

Në vitin 2021, nga shtetësia e Republikës së Kosovës janë liruar 4,938 persona, kurse 91 janë refuzuar për mos plotësimin e kriterëve ligjore. Sipas të dhënave në grafik vërejmë se gjatë vitit 2021 kishte rritje të vendimeve pozitive prej 36% krahasuar me vitin 2020 (3,633).

Gjatë vitit 2021, personat të cilët janë liruar nga shtetësia e Republikës së Kosovës sipas shteteve, 4,338 (87.8%) janë nga Gjermania, 431 (8.7%) nga Austria, 79 (1.6%) nga Sllovenia dhe 90 (1.8%) nga shtetet e tjera.

Figura 7: Numri i personave që janë liruar nga shtetësia e Republikës së Kosovës, 2019-2021



Burimi: DSHAM

Gjatë periudhës 2019-2021, trendët e lirimimit nga shtetësia e Republikës së Kosovës janë të përafërta, përjashtuar vitin 2020, kur për shkak të pandemisë edhe trendi i lirimimit nga shtetësia e Republikës së Kosovës kishte rënie. Gjatë kësaj periudhe 3 vjeçare, janë liruar 13,963 persona, ku dominon gjinia mashkullore me 7,195 (51.5%) krahasuar me gjininë femërore 6,768 (48.4%).



## 4. Migrimi i Parregullt

Migrimi i parregullt ka mbetur një sfidë për institucionet e Republikës së Kosovës, në veçanti në menaxhimin e lëvizjeve të përziera të migrantëve duke shfrytëzuar territorin e Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2021, institucionet e Republikës së Kosovës janë përqendruar në zgjerimin e kapaciteteve akomoduese për migrantë dhe refugjatë dhe ka ndërtuar dhe funksionalizuar Qendrën e Përkohshme të Pritjes për Migrantë.

### 4.1. Autoritetet Shtetërore Përgjegjëse

Ministria e Punëve të Brendshme është institucioni përgjegjës për hartimin e politikave që ndërlidhen me migrimin e parregullt, si dhe për zbatimin e politikave që ndërlidhen me imigrim të parregullt në Republikën e Kosovës.

Departamenti i Policisë Kufitare, në kuadër të Policisë së Kosovës, është përgjegjës për menaxhimin dhe kontrollin e kufirit shtetëror. Në kuadër të këtij Departamenti, funksionon Drejtoria për Migrim dhe të Huaj (DMH) e cila ka mandat për kontrollimin e hyrjes, lëvizjes dhe qëndrimit të të huajve në territorin e Republikës së Kosovës.

Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar (DHKO) në kuadër të Departamentit të Hetimeve merret me parandalimin dhe luftimin e kontrabandimit me migrantë.

Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (DHTQNJ), është drejtori e specializuar e Policisë së Kosovës e ngarkuar me përgjegjësinë për hetimin e rasteve dhe veprave të tjera që ndërlidhen me trafikimin me njerëz.

## 4.2. Politikat dhe Korniza Ligjore

Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar politikat dhe kornizën ligjore<sup>19</sup> me qëllim të parandalimit të migrimit të parregullt, luftimit të kontrabandimit me migrantë dhe trafikimit me qenie njerëzore.

Gjatë vitit 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Planin e Reagimit për Menaxhimin e Fluksit të Mundshëm të Migrantëve, Refugjatëve dhe Aplikuesve.<sup>20</sup> Strategjia Kombëtare për Migrim 2021-2025 ka parashikuar masat lidhur me parandalimin e migrimit të parregullt, luftimin e kontrabandimit me migrantë, si dhe luftimin e trafikimit me njerëz në mesin e migrantëve.<sup>21</sup>

## 4.3. Statistikat

### 4.3.1. Imigrimi i Parregullt

#### *Refuzimi i hyrjeve*

Të dhënat nga viti 2021 tregojnë se numri i përgjithshëm i personave të cilëve u është refuzuar hyrja në pikat e kalimit kufitar (PKK) është 7,436, duke shënuar një rritje prej 141% në krahasim me vitin 2020 dhe 145% krahasuar me vitin 2019.

---

<sup>19</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës; Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Kosovës, (KPK); Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK); Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur; Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë e Republikës së Kosovës; Ligji Nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit; Ligji Nr. 04/L-219 për të Huaj dhe Ligji Nr. 03/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huaj; Ligji Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit; Ligji Nr.04/L-125 për Shëndetësi; Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Plani i Veprimit 2015-2019; Strategjia e punës e DHTQNJ-së dhe Plani Vjetor i Veprimit; Aktet e tjera normative të PK-së, Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 04/2020 për Refuzimin e Hyrjes në Republikën e Kosovës, (Udhëzimet Administrative, Parimet, Procedurat Standarde të Operimit dhe vendimet); Procedurat Standarde të veprimit për viktimat e trafikimit; Standardet minimale për kujdesin ndaj viktimave të trafikimit; Strategjia afatgjate për riintegrimin e viktimave të trafikimit.

<sup>20</sup> Vendimi Nr.14/15 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 23.12.2021.

<sup>21</sup> Vendimi Nr. 10/39 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 13.10.2021.

Tabela 5: Refuzim i hyrjeve në Pikë Kalimet Kufitare, 2019-2021

Viti	2019	2020	2021
Numri i personave	3,029	3,082	7,436


Burimi: Njësia e Analizës së Rrezikut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit – Policia e Kosovës.

Nga numri i përgjithshëm i personave të refuzuar në hyrje të kufirit në vitin 2021, 75% (5,383) prej tyre janë nga shtetet e rajonit (Ballkanit Perëndimor), 10% (745) nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Shengen, 10% (743) nga shtetet aziatike, 5% (372) nga shtete të tjera. Arsyet për refuzim të hyrjeve në kufi për shtetasit e vendeve fqinje (Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi) ishte mungesa e dokumenteve të vlefshme ose ndalesat për të hyrë në Republikën e Kosovës, ndërsa për shtetasit e shteteve anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen ishte mungesa e letërnjoftimeve biometrike apo pasaportave dhe mungesa e testeve negative për Covid-19. Shtetasve të shteteve aziatike dhe afrikane u është refuzuar hyrja për shkak të mungesës së vizës, mjeteve të pamjaftueshme financiare, mosjustifikimi i qëllimit dhe kushteve të qëndrimit, si dhe mungesa e testeve negative për Covid-19.

#### 4.3.2. Kalimi i Paautorizuar i Kufirit

Gjatë vitit 2021, numri i imigrantëve të parregullt që kanë kaluar kufirin dhe kanë hyrë në territorin e Republikës së Kosovës në mënyrë të paautorizuar ka qenë 1,405, krahasuar me vitin 2020 (2,564), kemi rënie prej 45%, ndërsa në krahasim me vitin 2019 kemi rënie për 31%.

Figura 8: Numri i imigrantëve që kanë hyrë në Kosovë në mënyrë të paautorizuar, 2019-2021



Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit – Policia e Kosovës


Nga numri i përgjithshëm i imigrantëve të parregullt që kanë kaluar kufirin në mënyrë të paautorizuar 1,405, numri më i madh i tyre është nga Siria 708 (50.4%), Maroku 214 (15.2%), Bangladeshi 114 (8.1%), Algjeria 83 (6%), Afganistani 81 (5.7%), Libia 59 (4.2%), Iraku 36 (2.5%), Palestina 32 (2.2%), dhe shtete të tjera 78 (5.5%). Gjinia mashkullore përfaqësohet me 1,347 (96%) të imigrantëve të parregullt, ndërsa gjinia femërore me 58 (4%). Për nga grup-mosha, 188 (13%) imigrantë të parregullt ishin të moshës nën 18 vjeç, ndërsa 1,222 (87%) të moshës madhore (mbi 18 vjeç). Rastet e trajtuara tregojnë se imigrantët e parregullt kanë lëvizur në grupe të vogla, të ndihmuar nga kontrabandistët, të cilët në territorin e Republikës së Kosovës kanë hyrë kryesisht përmes kufirit me Shqipërinë. Nga 1,405 imigrantë që kanë hyrë në mënyrë të parregullt në territorin e Republikës së Kosovës përqindja më e madhe ishte nga Shqipëria me 1,234 (87%), Maqedonia e Veriut 132 (10%), Serbia 39 (3%).

#### 4.3.3. Luftimi i Kontrabandimit me Migrantë

Policia e Kosovës ka vazhduar kontrollet sistematike dhe të hollësishme në të gjitha pikat e kalimit kufitar dhe përgjatë vijës së gjelbër të kufirit, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të

kontrabandimit me migrantë. Po ashtu, janë luftuar edhe grupet e organizuara kriminale brenda territorit të Republikës së Kosovës të cilët janë marrë me kontrabandë me migrantë.

Figura 9: Rastet e iniciuara të kontrabandës me migrantë, 2019-2021



Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit dhe Drejtoria për Hetimin e Krimin të Organizuar, Policia e Kosovës

Gjatë vitit 2021, numri i rasteve të iniciuara për veprën penale të kontrabandimit me migrantë nga Policia e Kosovës ishte 30, krahasuar me vitin 2020 (25 raste). Numri i personave të dyshuar të kontrabandimit me migrantë gjatë vitit 2021 ishte 67, krahasuar me vitin 2020 ka rritje për 34 persona të dyshuar apo për 97%. Nga 67 persona të dyshuar për kontrabandë me migrantë, 52 (78%) ishin shtetas të Republikës së Kosovës, 9 (13%) ishin shtetas të shteteve aziatike, 3 (4%) shtetas të Maqedonisë së Veriut, 2 (3%) të Serbisë.

Tabela 6: Të dyshuarit për kontrabandë me migrantë sipas shtetësisë, 2019-2021

Shtetësia	2019	2020	2021
Kosovë	24	27	52
Shqipëri	3	4	1
Serbi	1	2	2
Turqi	1	1	1
Maqedoni e Veriut	3	0	3
Siria	2	0	1
Irak	1	0	1
Algjeri	0	0	2
Palestinë	0	0	2
Liban	0	0	1
Jordani	0	0	1
<b>Gjithsej</b>	<b>35</b>	<b>34</b>	<b>67</b>

Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit dhe Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar, Policia e Kosovës

#### 4.3.4. Trafikimi me Qenie Njerëzore

Të dhënat vjetore tregojnë se gjatë vitit 2021 është identifikuar një viktimë e trafikimit (e huaj), krahasuar me vitin 2020 që nuk kishte asnjë viktimë e identifikuar.

Në pjesën e dytë të vitit 2021 kanë filluar masat lehtësuese lidhur me lirinë e lëvizjes si pasojë e pandemisë me Covid-19, dhe kjo mund të ketë ndikuar në identifikimin e një viktime të huaj të trafikimit. Gjatë vitit 2021, DHTQNJ së bashku me DMH-në kanë organizuar dhe zbatuar 7 plane operative për inspektimin e lokacioneve të ndjeshme me qëllim të identifikimit të mundshëm të viktimave të trafikimit. Në këto lokacione janë hasur një numër i madh i shtetasve të huaj duke punuar pa dokumentacione përkatëse, me qëndrim të parregullt, të njëjtëve iu është ofruar mundësia e deklaramit nëse janë viktima të trafikimit.

Tabela 7: Viktimat e trafikimit sipas shtetësisë, 2019-2021

Viktima të Trafikimit të identifikuar / origjina	2019	2020	2021
Shqipëri	1	0	1
Mali i Zi	2	0	0
Serbi	2	0	0
<b>Gjithsej</b>	<b>5</b>	<b>0</b>	<b>1</b>

Burimi: Drejtoria për Hetimin dhe Trafikimin me Qenie Njerëzore, Policia e Kosovës

#### 4.3.5. Emigrimi i Parregullt

Kjo pjesë pasqyron emigrimin e parregullt të shtetasve të Republikës së Kosovës drejt shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Shengen. Analiza përfshinë shtetasit kosovarë, të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi ose janë zënë në kufi, janë zënë me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, me qëndrim të parregullt në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen, me urdhër për largim si dhe të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen në bazë të urdhrit për largim. Numërimi i dyfishtë i të njëjtit person nga raportimi i shteteve të ndryshme anëtare të BE-së dhe zonës Schengen nuk mund të përjashtohet<sup>22</sup>. Të dhënat për vitin 2020 dhe 2021, nuk përfshijnë statistikën për Mbretërinë e Bashkuar.

<sup>22</sup> Të dhënat për shtetasit e vendeve të treta të pranishëm ose të urdhëruar të largohen në mënyrë të paligjshme konsolidohen në nivel të shtetit anëtar, jo në nivel të BE-së. Kjo do të thotë se i njëjti shtetas i një vendi të tretë mund të regjistrohet si i pranishëm në mënyrë të paligjshme ose të urdhërohet të largohet në disa Shtete Anëtare gjatë së njëjtës periudhë referimi. Si rezultat, totali i BE-së mund të mbivlerësohet.

#### *4.3.5.1. Shtetasit kosovarë të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi ose janë zënë në kufi në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen*

Numri i përgjithshëm i shtetasve të Republikës së Kosovës që u refuzuan ose u zunë në kufijtë e jashtëm të shteteve anëtare të BE-së dhe Zonës Schengen në vitin 2021, ishte rreth 1,700<sup>23</sup> persona, krahasuar me vitin 2020 (1,255) kishte rritje prej 26.1%. Nga numri i përgjithshëm i refuzimeve të regjistruara për shtetasit kosovarë, ngjajshëm sikurse vitin paraprak, rreth tri të katërtat u refuzuan të hynë në kufijtë e Kroacisë me 530 persona (31%), Sllovenisë me 410 persona (24%), Hungarisë me 325 persona (19%) dhe shtetet tjera me 435 persona (26%).

Arsyet kryesore për refuzimin e hyrjes në kufijtë e jashtëm të BE-së dhe zonës Schengen<sup>24</sup>, ishin që më shumë se tri të katërtat apo 74% (1,150) e numrit të përgjithshëm, nuk mund të justifikonin arsyen e një vize apo qëndrimi të vlefshëm, personi konsiderohej si një kërcënim publik me 13% (205), kishin dokumente të udhëtimit të falsifikuara 5% (70), nuk kishin dokumente të vlefshme 3% (45), kishin vizë apo leje qëndrimi të falsifikuar 3% (45), mjetet e pamjaftueshme të jetesës 1% (10) dhe personi ka qëndruar tashmë 3 muaj në një periudhë 6 mujore 0.4% (5).

Shumica dërmuese prej 84% e shtetasve të Republikës së Kosovës, të cilëve iu refuzua hyrja në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Shengen, u ndaluan në kufijtë e jashtëm tokësor, përqindja e refuzimeve në kufijtë ajror ishte 14%, ndërsa vetëm një pjesë e vogël 2% e refuzimeve ishin në kufijtë detarë (kryesisht në kufij me Italinë).

Shumica e shtetasve kosovarë që nuk mund të justifikonin një vizë apo qëndrimin të vlefshëm, iu refuzua hyrja në kufijtë kroat 360 personave (31%), sllovenë 360 personave (31%) dhe hungarezë 215 personave (19%) dhe vendet tjera 215 personave (19%), kurse për persona që konsideroheshin si kërcënim publik iu refuzua hyrja në kufijtë kroat 85 personave (41%), bullgarë 40 personave (20%), sllovenë 20 personave (10%) dhe vendet tjera 60 personave (29%).

<sup>23</sup> [https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr\\_eirfs&lang=en](https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr_eirfs&lang=en), përditësimi i fundit, më datën, 18 maj 2022.

<sup>24</sup> Arsyet kryesore bazohen në Kodin e Kufijve të Shengenit



Kriteret e hyrjes lidhur me situatën pandemike Covid-19, duke përfshirë një reduktim mbarëbotëror të udhëtimeve mund të ketë ndikuar në rritjen e refuzimeve të hyrjeve të shtetasve kosovarë në kufijtë e shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Shengen.

#### *4.3.5.2. Shtetasit kosovarë të cilët janë zënë me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen*

Shtetasit kosovarë që kanë kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme dhe që nuk kanë pasur të drejtë të qëndrojnë në territorin e shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Shengen për vitin 2021, ishte gjithsej 3,980 persona<sup>25</sup>. Krahasuar me vitin 2020 (4,515), kishte një rënie prej 13.4%. Ky numër është më i ulët i regjistruar që nga viti 2008.

Shtetet Anëtare të BE-së dhe zonës Shengen, që raportuan numër më të madh të shtetasve kosovarë me qëndrim të parregullt në vitin 2021, ishin: Gjermania 1,265 (32%), e pasuar nga Franca 895 (22.5%), Kroacia 515 (13%), Hungaria 415 (10%), Austria 335 (8%), dhe shtetet tjera 555 (14%). Vetëm në dy shtetet anëtare të BE-së (Gjermani dhe Francë) me qëndrim të parregullt u kapën më shumë se gjysma 2,160 (54%) të shtetasve kosovarë.

Sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se kryesisht meshkujt përbënin rreth 86.7%, të atyre që u kapën me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Shengen në krahasim me gjininë femrore e cila përbënte 13.3%, kjo përqindje ishte më e larta e regjistruar që nga viti 2008, në dobi të gjinisë mashkullore.

Mosha 18-34 vjeçare përbënte 57% të numrit të përgjithshëm, mosha 35 vjeç e lartë përbënte 36%, mosha nga 14-17 vjeç përbënte 3%, me 1% ishin të moshës nën 14 vjeç, si dhe me 3% të moshës së panjohur.

Nga numri i përgjithshëm i hyrjeve të paligjshme, Franca raportoi numrin më të madh të shtetasve kosovarë me 47%, e pasuar nga Kroacia me 24%, Sllovenia 12% dhe shtetet tjera me 17%.

---

<sup>25</sup> [https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr\\_eipre&lang=en](https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr_eipre&lang=en), përditësimi i fundit më, 13 qershor 2022

Nga numri i përgjithshëm i të gjithë shtetasve jo-anëtarë të BE-së që rezultuan se ishin ilegalisht të pranishëm në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen 702,380, shtetasit kosovarë përbënin rreth 0.6%.

#### *4.3.5.3. Shtetasit kosovarë me qëndrim të parregullt në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen me urdhër për largim*

Në vitin 2021, numri i përgjithshëm i shtetasve kosovarë të urdhëruar të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Shengen ishte 4,015<sup>26</sup>. Numri i përgjithshëm i kësaj kategorie vazhdon të bjerë në vazhdimësi që nga viti 2015, ku edhe në vitin 2021, pati rënie prej rreth 6.6%, në krahasim me vitin 2020 (4,280).

Numri i përgjithshëm i urdhër largimeve të shtetasve kosovarë nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Shengen në vitin 2021 sipas shteteve u regjistruan në: Francë 1,360 (34%), Gjermani 510 (13%), Kroaci 605 (15%), Slloveni 325 (8%), Zvicër 270 (7%), dhe shtetet tjera 945 (23%).

Bazuar në të dhënat e disponueshme, numri i të miturve të pashoqëruar<sup>27</sup> me shtetësi të Republikës së Kosovës me urdhër për t'u larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Shengen ishte 40 persona. Ky numër është regjistruar vetëm në Kroaci dhe të gjithë ishin të gjinisë mashkullore.

#### *4.3.5.4. Shtetasit kosovarë të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen në bazë të urdhrit për largim*

Në vitin 2021, numri i përgjithshëm i personave të kthyer si shtetas kosovarë, të cilët u larguan në bazë të një urdhëri për largim nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen, ishte 1,680<sup>28</sup>. Ky numër krahasuar me vitin 2020 që ishte 1,410, shënon një rritje prej rreth 16%.

<sup>26</sup> [https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr\\_eiord1&lang=en](https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr_eiord1&lang=en), përditësimi i fundit më, 30 qershor 2022, nga të dhënat 3-mujore.

<sup>27</sup> Një i mitur i pashoqëruar është një person që është më pak se 18 vjeç, i cili mbërrin në territorin e një shteti anëtar të BE-së i pashoqëruar nga një i rritur përgjegjës për të miturin ose një i mitur që lihet i pashoqëruar pasi ka hyrë në territorin e një shteti anëtar. Të dhënat për këtë kategori janë publikuar për herë të parë në vitin 2021.

<sup>28</sup> <https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>, përditësimi i fundit më, 30 qershor 2022, nga të dhënat kvartale

Pothuajse 48% e shtetasve kosovarë të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen në bazë të urdhrit për largim ishin nga Gjermania 395 (24%) dhe Kroacia 395 (24%), përderisa pjesa tjetër është regjistruar në Francë 240 (14%), Zvicër 155 (9%), Austri 130 (8%) dhe shtetet e tjera me 365 (21%).

Sipas të dhënave për llojet e kthimeve dhe ndihmave të marra (mbledhja e detyrueshme e të dhënave për këtë kategori ka filluar në 2021), nga numri i përgjithshëm i personave të kthyer shtetas kosovarë, të cilët u larguan në bazë të një urdhëri për largim nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen, me kthime të detyruara kishin të bënin 1,320 (79%)<sup>29</sup>, kthimi vullnetar i asistuar 205 (12%)<sup>30</sup> dhe kthimi vullnetar i pa asistuar 156 (9%)<sup>31</sup>.

Numri i të miturve të pashoqëruar<sup>32</sup> kosovarë të cilët u larguan në bazë të një urdhëri për largim ishte 15 persona. Ky numër u regjistrua vetëm në Kroaci.

---


<sup>29</sup> **Kthimi i detyruar:** kthimi i detyrueshëm në shtetin e origjinës, transitit ose një shtet tjetër të tretë, në bazë të një akti administrativ ose gjyqësor.

<sup>30</sup> **Kthimi vullnetar i asistuar:** kthimi i një joshetasi të BE-së me ndihmën e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) ose organizata të tjera të cilave u është besuar zyrtarisht ky mision.

<sup>31</sup> **Kthimi vullnetar:** nisja e asistuar ose e pavarur drejt shtetit të origjinës, transitit ose një shteti tjetër të tretë bazuar në vullnetin e të kthyerit.

<sup>32</sup> <https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>, përditësimi i fundit, më 04 korrik 2022.

Figura 10: Shtetasit kosovarë të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi, janë zënë me qëndrim të parregullt janë urdhëruar të largohen dhe janë larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen, 2019-2021



Burimi: Eurostat

## 5. Kthimi, Ripranimi dhe Riintegrimi

Ky kapitull përfshin një përmbledhje të procesit të kthimit, ripranimit dhe riintegrimin, me të dhëna të hollësishme rreth numrit të të kthyerve vullnetarë dhe atyre të kthyer me forcë. Kapitulli mbulon kthimin e shtetasve të huaj, kthimin e shtetasve të Republikës së Kosovës, si dhe riintegrimin e tyre në shoqëri.

### 5.1. Kthimi i të Huajve

#### 5.1.1. Autoritetet Shtetërore Përgjegjëse

Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim (në kuadër të MPB-së) dhe Policia Kufitare e Kosovës, janë autoritetet përgjegjëse për kthimin e të huajve me qëndrim të paligjshëm në Republikën e Kosovës, në vendet e origjinës apo në vendin e fundit të qëndrimit të të huajve.

#### 5.1.2. Politikat dhe Korniza Ligjore

Është kompletuar korniza ligjore lidhur me kthimin e të huajve në vendet e origjinës dhe nuk ka pasur zhvillime të reja legislative dhe të politikave.


Gjatë vitit 2021 ka vazhduar zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM) në fushën e menaxhimit të migrimit “Kthimi i asistuar vullnetar dhe riintegrimi”. Si rezultat i zbatimit të kësaj marrëveshje është bërë kthimi i 18 të huajve (9 Nepal, 4 Jordani, 2 Shqipëri, 1 Gjermani, 1 Somali dhe 1 Bangladesh).

#### 5.1.3. Statistikat

##### 5.1.3.1. Vendimet për Largim Vullnetar

Gjatë vitit 2021 janë lëshuar 114 vendime për largim vullnetar nga territori i Republikës së Kosovës, duke shënuar rënie për 24% (150) në krahasim me vitin 2020 dhe 65% (327) në krahasim me vitin 2019.

Figura 11: Vendimet për largim vullnetar, 2019-2021




Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrimit të Dhënave, Departamenti i Kufirit

Numri më i madh i vendimeve për largim vullnetar sipas shteteve ishin për shtetasit e Shqipërisë me 48 (42%) vendime, Serbisë me 20 (18%), Turqisë me 9 (8%), Indisë me 8 (7%), Afrikës së Jugut me 5 (4%), kurse 24 (21%) vendime ishin për shtetasit e shteteve tjera. Nga numri i përgjithshëm i vendimeve për largim vullnetar, 62 (54%) vendime janë lëshuar për gjininë femërore dhe 52 (46%) vendime për gjininë mashkullore. Arsyet e lëshimit të vendimeve për largim vullnetar për të huajt me qëndrim të parregullt në Republikën e Kosovës ishin mungesa e lejes së vlefshme të qëndrimit, anulimi ose revokimi i lejes së qëndrimit, ose janë zënë duke punuar në kundërshtim me dispozitat e parapara me Ligjin për të Huajt ose me ligjet e tjera në fuqi.

### 5.1.3.2. Vendimet për Largim me Forcë

Gjatë vitit 2021 janë lëshuar 58 vendime për largim me forcë nga territori i Republikës së Kosovës, duke shënuar rënie për 39% (95) në krahasim me vitin 2020 dhe 65% (110) në krahasim me vitin 2019.

Figura 12: Vendimet për largim me forcë, 2019-2021




Burimi: Departamenti i Policisë Kufitare – Drejtoria për Migrim dhe të Huaj

Sipas gjinisë, 45 (78%) vendime të ekzekutuara për largim me forcë kanë qenë të gjinisë femërore, ndërsa 13 (22%) të gjinisë mashkullore. Sipas shtetësisë, 42 (72%) ishin shtetas të Shqipërisë, 7 (12%) të Serbisë dhe 9 (16%) të vendeve tjera.

### 5.1.3.3. Dëbimi me Vendim Gjykatë

Drejtoria për Migrim dhe të Huaj me vendim të gjykatave të Kosovës dhe duke u bazuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, ka dëbuar nga Republika e Kosovës 33 persona. Krahasuar me vitin 2020 është shënuar rënie për 3% (34 dëbime). Nga këto dëbime, 15 persona ishin shtetas të Shqipërisë, 8 të Serbisë, 3 të Jemenit, 2 të Malit të Zi, 2 të Indisë, 1 të Armenisë, 1 i Turqisë dhe 1 i Zvicrës.

Figura 13: Vendimet për largim me vendim gjykatë, 2019-2021



Burimi: Departamenti i Policisë Kufitare – Drejtoria për Migrim dhe të Huaj

## 5.2. Ripranimi

### 5.2.1. Autoritetet Shtetërore Përgjegjëse

Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim/Divizioni për Ripranim dhe Kthim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është autoriteti kryesor shtetëror përgjegjës për zbatimin e Ligjit Nr. 03/1-208 për Ripranim, si dhe të marrëveshjeve bilaterale të ripranimit.

Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në kuadër të Policisë Kufitare është përgjegjës për lejimin apo refuzimin e kërkesave për kalim transit të shtetasve të vendeve të treta.

### 5.2.2. Politikat dhe Korniza Ligjore

Ligji për Ripranim përcakton rregullat dhe procedurat për ripranimin e një personi i cili është shtetas i Republikës së Kosovës ose i huaj, i cili nuk i plotëson kushtet për hyrje ose qëndrim në territorin e shtetit kërkuar. Zbatimi i legjislacionit për ripranim ka përparësi në aspektin e



bashkëpunimit për ripranimin me vendet me të cilat Kosova ende nuk ka nënshkruar një marrëveshje dypalëshe për ripranim.

Gjatë vitit 2021 ka vazhduar zbatimi i Ligjit Nr. 03/1 - 208 për Ripranim, si dhe marrëveshjeve të ripranimit.

Deri në vitin 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nënshkruar marrëveshje ripranimi me 24 vende<sup>33</sup>, 20 prej të cilave janë vende anëtare të BE-së dhe vendet e Shengenit.

### 5.2.3. Statistikat

Në vitin 2021 janë ripranuar 848 persona, me forcë 84% (710)<sup>34</sup>, vullnetarë 45 (5%) dhe vullnetarë të asistuar nga IOM 93 (11%)<sup>35</sup>, dhe ka ngritje prej 32% krahasuar me vitin 2020 që kishte rreth 644 persona të ripranuar, më forcë 512 (79.5%), vullnetarë 19 (3%) dhe vullnetarë të asistuar nga IOM 113 (17.5%) të shtetasve të Republikës së Kosovës.

Në bazë të dhënave vjetore, sipas strukturës gjinore dhe moshës, nga shtetasit kosovarë të ripranuar me forcë gjatë vitit 2021, të gjinisë mashkullore janë 586 (82.5%), ndërsa të gjinisë femërore 124 (17.5%). Të ripranuar vullnetarë gjatë vitit 2021, të gjinisë mashkullore janë 27 (60%) dhe 18 (40%) të gjinisë femërore.

Prej numrit të përgjithshëm të ripranuarve, me të kaluar kriminale janë 142 persona.

Ndërsa sipas të dhënave nga IOM të ripranuarit vullnetarë gjatë vitit 2021, të gjinisë mashkullore janë 62 (67%) dhe të gjinisë femërore janë 31 (33%).


---

<sup>33</sup> Ligji Nr.03/L-208 Për Ripranim, 2009 Republika e Shqipërisë, 2009 Republika e Francës, 2010 Këshilli Federal Zviceran, 2010 Republika Federale e Gjermanisë, 2010 Mbretëria e Danimarkës, 2010 Republika e Austrisë, 2010 Mbretëria e Norvegjisë, 2011 Republika e Sllovenisë, 2011 Beneluxi (Belgjikë, Holandë dhe Luksemburg), 2011 Republika e Çekisë, 2011 Mali i Zi, 2011 Mbretëria e Suedisë, 2011 Republika e Finlandës, 2012 Republika e Hungarisë, 2012 Republika e Bullgarisë, 2012 Republika e Maltës, 2013 Republika e Estonisë, 2013 Principata e Lihtenshtajnit, 2013 Republika e Kroacisë, 2014 Republika e Italisë, 2015 Republika e Turqisë dhe 2017 Republika e Maqedonisë së Veriut.

<sup>34</sup> Burimi: MPB (me forcë dhe vullnetarë)

<sup>35</sup> Burimi: IOM (vullnetarë të asistuar)

Figura 14: Ripranimi vullnetar dhe me forcë, 2019-2021



Burimi: DSHAM, IOM

Sipas moshës përqindja më e madhe e të ripranuarve (me forcë, vullnetarë dhe vullnetarë të asistuar nga IOM) janë të grup-moshave 18-34 (346 ose 41%) dhe 35-64 (350 ose 41.3%) janë me numër më të madh të ripranuarve ndërsa grup-moshat tjera me 152 ose 18%.

Sipas të dhënave vjetore për vitin 2021 (848), numri më i madh i të ripranuarve (me forcë, vullnetarë dhe vullnetarë të asistuar), janë nga Gjermania 450 (53%), Zvicra 140 (17%), Franca 72 (8%) dhe shtete të tjera me 186 (22%). Ndërsa sipas të dhënave vjetore për vitin 2020 (644), numri më i madh i të ripranuarve (me forcë, vullnetarë dhe vullnetarë të asistuar) ishin nga Gjermania 336 (52%), Franca 112 (17%), Belgjika 40 (6%) dhe shtetet të tjera me 156 (24%).

Nga këto të dhëna mund të shohim se trendi i ripranimit (me forcë, vullnetarë dhe vullnetarë të asistuar) gjatë tre viteve të fundit (2019-2021) është në rënie.

Rreth 94% e rasteve të ripranimit u trajtuan në bazë të marrëveshjeve dypalëshe të ripranimit me vendet anëtare të BE-së, 5% e rasteve të ripranimit u bazuan në marrëveshjet dypalëshe të ripranimit me vendet jo anëtare të BE-së, ndërsa më pak se 1% e rasteve të ripranimit u trajtuan në përputhje me Ligjin për Ripranim.

## 5.3. Riintegrimi

### 5.3.1. Autoritetet Shtetërore Përgjegjëse

Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve (DRPRIH) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme është autoriteti përgjegjës për menaxhimin dhe mbështetjen e riintegritit të personave të riatdhesuar.<sup>36</sup>

### 5.3.2. Politikat dhe Korniza Ligjore

Politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në fushën e migrimit dhe riintegritit të personave të riatdhesuar, janë të përcaktuara me Strategjinë Shtetërore për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në Kosovë 2018-2022, Planin e Veprimit të Strategjisë Shtetërore për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2018 – 2022<sup>37</sup>, Strategjinë Shtetërore për Migrim 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2021-2023, si dhe Rregulloren QRK Nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar.<sup>38</sup>

Institucionet e tjera përgjegjëse, kriteret dhe procedurat ndihmëse dhe mbështetëse të personave të riatdhesuar gjatë procesit të riintegritit rregullohen përmes Rregullores (QRK) Nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, e cila ka për qëllim avancimin e kuadrit ligjor për riintegrimin e personave të riatdhesuar.<sup>39</sup>

Në kuadër të avancimit të politikave të riintegritit, gjatë kësaj periudhe janë hartuar dokumentet si në vijim:

- Udhëzuesi i Mirëqenies Mendore për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në RKS.

---

<sup>36</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=318622>

<sup>37</sup> Strategjia për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar është inkorporuar në Strategjinë për Migrim 2021-2025

<sup>38</sup> <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40273>

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41097>

<sup>39</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=31862>

- Është finalizuar dhe shpërndarë nëpër komuna Manuali për “Vlerësimin e Nevojave dhe Ofrimin e Mbështetjes Psiko-Sociale për Personat e Riatdhesuar në Republikën e Kosovës”.
- Është finalizuar dhe shpërndarë nëpër komuna Infografika (fletpalosjen informative) lidhur me masat e Riintegritit për të Riatdhesuarit në Republikën e Kosovës.

Me qëllim të lehtësimit të zbatimit të politikave të riintegritit, Ministria e Punëve të Brendshme/DRPR, ka përcaktuar mënyrat dhe formatin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit me palët e interesit në nivel qendror dhe lokal, organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile, si dhe ka të nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të mira për personat e riatdhesuar.

### 5.3.3. Statistikat

Gjatë vitit 2021, në kuadër të skemave të ndryshme emergjente dhe të riintegritit të qëndrueshëm janë mbështetur 5,862 persona të riatdhesuar<sup>40</sup>, duke shënuar rënie prej 36% në krahasim me vitin 2019 si rezultat i pandemisë Covid-19.

Sipas përkatësisë etnike<sup>41</sup> numri më i madh i përfituesve gjatë vitit 2021 i takon komunitetit Shqiptar me 526 (65.3%), pastaj komunitetit Rom me 101 (12.5%), Ashkali 100 (12.4%), Egjiptian 45 (5.6%), si dhe komunitete të tjera.

Ndërsa, sipas komunave të origjinës për vitin 2021, numri më i madh i përfituesve në skemat e ndryshme nga buxheti i riintegritit është nga komuna e Mitrovicës me 91 (11.3%) përfitues,

<sup>40</sup> **Sqarim:** Numri i përfituesve prej 5,862 pasqyron personat e riatdhesuar të ri dhe të bartur edhe nga vitet e kaluara por të mbështetur në skemat e ndryshme për riintegrim gjatë vitit 2021 nga DRPRIH/ Buxheti i Riintegritit dhe Organizatat Ndërkombëtare që mbështesin procesin e riintegritit, prej tyre (1,164 persona përfitues janë Institucionet Vendore që përfshin 806 persona përfitues nga Departamenti për Riintegrim e Personave të Riatdhesuar/Buxheti i Riintegritit dhe 358 persona nga institucionet vendore (I.V) si dhe (4,698 persona nga Organizatat Ndërkombëtare (O.N) që mbështesin procesin e riintegritit.

Përfituesit nga organizatat ndërkombëtare dhe institucionet vendore bazohen në programet (kriteret) e tyre mbështesë, në kuadër të tyre përfitues ka persona të riatdhesuar të vitit raportues dhe viteve tjera.

<sup>41</sup> Sqarim - numri i përfituesve i cekur në tekst sipas përkatësisë etnike, komunave të origjinës dhe shteteve të kthimit pasqyron personat përfitues në skemat e ndryshme vetëm nga buxheti i riintegritit DRPRIH-ja, sepse nga institucionet vendore dhe organizatat ndërkombëtare janë pranuar të dhëna statistikore në mënyrë gjenerale pa këto të dhëna specifike.


Prishtinës me 80 (9.9%), Podujevës me 76 (9.4%), Prizren me 64 (7.9%), si dhe Fushë Kosovë me 60 (7.4%) etj.

Numri më i madh i personave që kanë përfituar nga skemat e ndryshme nga buxheti i riintegritit janë të riatdhesuarit nga Gjermania me 538 (66.7%), Siria me 116 (14.4%), Franca me 69 (8.5%), Suedia me 22 (2.7%), Zvicra me 21 (2.6%) etj.

Nga skemat për Riintegrim gjatë vitit 2021 dhe 2020, kanë përfituar 87 familje me 244 anëtarë të riatdhesuar që i takojnë grupeve të cënueshme, ndërsa në kategorinë e grupeve me nevoja specifike të cilat janë mbështetur në skemat e ndryshme për riintegrim, kanë përfituar gjithsej 57 familje me 134 anëtarë të riatdhesuar.


Në vijim janë paraqitur të dhënat për mbështetjen e personave të riatdhesuar sipas skemave të përfitimit.

Figura 15: Ndhimja menjëherë pas arritjes dhe ndihmat emergjente brenda 12 muajve pas riatdhesimit, 2019-2021.



Burimi: DRPRIH/MPB/Institucionet Vendore dhe Organizatat Ndërkombëtare

Figura 16: Ndihma për riintegrim të qëndrueshëm, 2019-2021



Burimi: DRPRIH/MPB/Institucionet Vendore dhe Organizatat Ndërkombëtare

Në kuadër të disa skemave për riintegrim të qëndrueshëm, gjatë periudhës 2019-2021 vërehet një rritje e konsiderueshme në skemën e financimit për themelimin e biznesit, shërbimet e konsulencës, trajnimin në punë, si dhe skemat e tjera, si rezultat i rritjes së bashkëpunimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve me organizatat ndërkombëtare që e mbështesin procesin e riintegrit.

## 6. Integrimi i të Huajve

Integrimi i të huajve në shoqërinë kosovare është i rregulluar përmes kornizës ligjore që ka të bëjë me Ligjin për të Huajt, Ligjin për Azil, Ligjin për Shtetësi, si dhe përmes Rregullores (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve e cila përcakton bazën e ndërtimit të sistemit të integritit të të huajve në Republikën e Kosovës.

### 6.1. Autoritetet Shtetërore Përgjegjëse

MPB/DRPRIH është përgjegjëse për menaxhimin dhe koordinimin e politikave të integritit në bashkëpunim të ngushtë me institucionet relevante qendrore dhe lokale.

Secila nga ministritë relevante parasheh masat e integritit, si pjesë e planit operativ dhe financiar të saj. Ministritë dhe komunat kanë caktuar zyrtarë përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve të integritit sipas legjislacionit në fuqi. Monitorimin e zbatimit të politikave të integritit në nivel lokal e bën MPB/DRPRIH.

### 6.2. Politikat dhe Korniza Ligjore

Korniza kryesore ligjore që rregullon integrimin e të huajve në Republikën e Kosovës është Rregullorja (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve e cila gjithashtu rregullon bazën e sistemit të integritit të të huajve në Republikën e Kosovës. Rregullorja përcakton procedurat, kriteret dhe institucionet përgjegjëse për integrimin e të huajve në jetën sociale, ekonomike dhe kulturore në Republikën e Kosovës. Integrimi i të huajve me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Kosovës është i rregulluar edhe përmes një numri të akteve të tjera ligjore. Kreu IX i Ligjit Nr. 04/1-219 për të Huajt (nenet 126 dhe 127), siguron bazën ligjore për kushtet dhe shërbimet e integritit të të huajve në jetën ekonomike, kulturore dhe shoqërore, përfshirë përgjegjësitë e institucioneve shtetërore dhe bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare me qëllim të promovimit dhe zbatimit të programeve për integrimin e të huajve në shoqëri. Legjislacioni në fuqi garanton të drejtën e fitimit të shtetësisë së Kosovës (përmes natyralizimit)<sup>42</sup>

---

<sup>42</sup> Ligji Nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës, Gazeta e Republikës së Kosovës/Nr. 33/2 shtator 2013, Prishtinë.

dhe qasjen në shërbime përkatëse me qëllim të lehtësimit të procesit të integrimit në shoqërinë kosovare.

Në kuadër të zbatimit të Rregullores (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve<sup>43</sup>, gjatë vitit 2021 janë hartuar dhe është duke u zbatuar:

- Udhëzuesi për zbatimin e Rregullores (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve në RKS.
- Janë duke u zbatuar dokumentet standarde të Vlerësimit të nevojave dhe Planit Individual të Integrimit.
- Janë finalizuar Fletëpalosjet Informative në 8 gjuhë për të drejtat dhe detyrimet e të huajve me status të mbrojtjes ndërkombëtare të cilat janë shpërndarë tek akterët relevant dhe personave të cilët kanë fituar statusin e mbrojtjes ndërkombëtare në RKS.
- Është finalizuar Plani Strategjik i ngritjes së kapaciteteve për zbatimin e politikave të riintegritimit dhe integrimit, në kuadër të cilit janë realizuar:
  1. Janë certifikuar 13 zyrtarë të DRPRIH për sistemin e Integrimit të Huajve në RKS.
  2. Janë realizuar 6 punëtori në nivel lokal të organizuar në 6 regjione të Kosovës me pjesëmarrjen e njëqind e njëmbëdhjetë 111 zyrtarëve për: Zbatimin në praktikë të Rregullores për Integrim Nr.09/2019, si dhe harmonizimin në integrimin e të huajve në nivel lokal”, definimin e përgjegjësive, roleve, kritereve dhe procedurave në ofrimin e shërbimeve për personat e huaj të cilët kanë fituar statusin e mbrojtjes ndërkombëtare në Republikën e Kosovës, të mbështetura UNHCR/ CRP/K-së dhe JRS-i.

Me Vendimin e Qerverisë Nr.17/52 të datës të datës 29.12.2021, është miratuar Koncept-dokumenti për Ligjin për Shtetësi, Projekt-udhëzimi Administrativ për ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 05/2017 për Kriteret që Përbëjnë Dëshmi për Shtetësinë e ish-RFJ-së, dhe Banimin e Përhershëm në Territorin e Kosovës më 1 janar 1998. Janë mbajtur disa takime me ekipin e punës dhe është përgatit drafti fillestar.

---

<sup>43</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21006>



Është në proces instalimi i bazës së të dhënave në të gjitha konsullatat e Republikës së Kosovës në mënyrë që të përmbillet me sukses i gjithë cikli i procesit të vendimmarrjes deri të dorëzimi i vendimeve tek palët, aktualisht ky proces ka stagnuar për arsye të pandemisë.


## 6.3. Statistikat

### 6.3.1. Fitimi i Shtetësisë së Republikës së Kosovës

Në vitin 2021, shtetësinë e Republikës së Kosovës e kanë fituar 421 persona, kurse 537 personave iu është refuzuar kërkesa për arsye të mosplotësimit të kriterëve ligjore. Krahasuar me vitin 2020 (177) ka patur ngritje të vendimeve pozitive prej 138%.

Gjatë vitit 2021, personat që kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës janë nga Serbia me 112 (26.6%), Shqipëria me 66 (15.7%), Maqedonia e Veriut me 45 (10.7%) dhe shtete të tjera me 198 (47%).

Figura 17: Numri i personave që kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës, 2019-2021



Burimi: DSHAM


Gjatë periudhës 2019-2021, trendi i fitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës është në ngritje. Gjatë kësaj periudhe, 888 persona kanë fituar shtetësinë, ku dominon gjinia femërore me 489 (55%) krahasuar me gjininë mashkullore me 399 (45%).

### 6.3.2. Skema e Integrimit të të Huajve

Gjatë vitit 2021, kanë fituar statusin e mbrojtjes ndërkombëtare 32 azilkërkues, 16 persona (10 familje) kanë përfituar statusin e refugjatit, ndërsa 16 persona (10 familje) kanë fituar statusin e mbrojtjes plotësuese.

Në vijim janë paraqitur të dhënat për mbështetjen e personave të huaj në skema të ndryshme për integrim.

Figura 18. Paraqet skemat e përfitimit për personat e huaj në procesin e Integrimit nga DRPRIH-ja dhe Organizatat Vendore dhe Ndërkombëtare



Burimi: DRPRIH/MPB

Janë organizuar testet e vlerësimit të integrit për 243 të huaj, prej tyre 47 persona kanë aplikuar për lejeqëndrim të përhershëm, si dhe 196 persona kanë aplikuar për fitim të shtetësisë në Republikën e Kosovës.

## 7. Migrimi dhe Zhvillimi

Në këtë kapitull pasqyrohen politikat dhe strategjitë zhvillimore të Republikës së Kosovës që ndërlidhen me migrimin dhe zhvillimin. Fokusi është vënë në prezantimin e mënyrave se si mund të përdoret potenciali i migrimit për qëllime zhvillimore, dërgesat (remitencat) dhe investimet nga diaspora, si dhe politikat e angazhimit të kthimit të ekspertëve nga diaspora (kthimi i dijes).

Programi i Qeverisë 2021-2025<sup>44</sup>, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030, Programi për Reforma në Ekonomi 2021-2023<sup>45</sup> dhe 2022-2024<sup>46</sup>, si dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së StabilizimAsociimit<sup>47</sup>, janë dokumentet kryesore që përcaktojnë orientimin dhe zhvillimin e politikave qeveritare dhe sigurojnë bazën për përcaktimin e prioritetëve të politikave të përfshira në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2023-2025<sup>48</sup>.

### 7.1. Autoritetet Shtetërore Përgjegjëse

Republika e Kosovës është ndër vendet që ka diasporën më të madhe dhe rol kryesor në ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kulturor të mërgatës tonë luan Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD). Krahas saj, edhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Ministria e Ekonomisë, dhe Ministria e Arsimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, në fushëveprimin e tyre përfshijnë hartimin e politikave dhe strategjive të cilat në mënyrë direkte apo indirekte rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me migrimin dhe zhvillimin. Qëllimi i përbashkët i këtyre institucioneve është krijimi i një klime të favorshme për tërheqjen e investimeve në përgjithësi dhe investimeve nga diaspora në veçanti.

---

<sup>44</sup> PROGRAMI I QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2021-2025, Maj 2021, <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>

<sup>45</sup> PRE 2021-2023, Janar 2021, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/E3E6B52B-7C91-43CE-9CDE-559A0053A89E.pdf>

<sup>46</sup> PRE 2022-2024, Janar 2022, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4417FC05-282D-46C0-B111-B3EA629C7960.pdf>

<sup>47</sup> PKZMSA 2021-2024, Tetor 2021, <http://mei-ks.net/sq/pkzmsa-2021-2024>

<sup>48</sup> KASH 2023-2025, Prill 2022, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/173B71AA-5CF6-4524-A885-02B4CE20A134.pdf>

**Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës**, përveç përkushtimit në politikën e jashtme<sup>49</sup>, angazhohet në ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit të pjesëtarëve të diasporës, promovimin dhe avancimin e të drejtave të tyre, organizimin e tyre në vendet ku jetojnë, si dhe promovimin e resurseve dhe mundësive për investimet e tyre në vendin e origjinës me qëllim të zhvillimit ekonomik.

**Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve** angazhohet që përmes politikave fiskale të krijojë klimë të favorshme për investime, duke përfshirë edhe investitorët nga diaspora. MFPT poashtu harton politika të punësimit dhe ka rol të rëndësishëm në promovimin e migrimit të rregullt, si dhe në ndërlidhjen e nevojave të tregut të punës me migrimin, dhe zhvillon programet përmes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK).

**Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë** është institucion tjetër i rëndësishëm që ndërlidh migrimin përmes politikave për përmirësimin e ambientit të biznesit siç është promovimi i investimeve dhe eksportit, fuqizimi dhe krijimi i zonave ekonomike, zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) dhe forcimi i sektorit privat në përgjithësi.

Ministria e Ekonomisë<sup>50</sup> përgatit dhe zbaton politika, të cilat nxisin rritjen dhe stabilitetin ekonomik, mundësojnë zhvillimin e biznesit vendas, nxisin bashkëpunimin ekonomik për tërheqjen e investimeve të huaja, garantojnë konkurrencën dhe një treg të sigurt, sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm e perspektiv të burimeve energjetike e minerare të vendit, sigurojnë zhvillimin e sektorit të telekomunikacionit dhe teknologjisë informative, si dhe garantojnë efikasitet në administrimin e ndërmarrjeve publike.

**Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit** (MASHTI) përmes politikave të saj siguron ruajtjen e identitetit, (kulturor, gjuhësor) duke krijuar kurrikula të veçanta për pjesëtarët e diasporës, si dhe programe të veçanta arsimore për çështjet e migrimit.

---

<sup>49</sup> <https://www.mfa-ks.net/politika/481/prioritetet-e-reja-t-politiks-s-jashtme-t-kosovs/481>

<sup>50</sup> <https://me.rks-gov.net/sq/misioni#.Y1JKhf1ByM8>

## 7.2. Politikat dhe Korniza Ligjore

**Programi i Qeverisë 2021-2025**, është dokumenti themelor me të cilin Qeveria e komunikon vizionin e saj para qytetarëve të Republikës së Kosovës për qeverisjen e saj. Në kuadër të prioritetit të dytë themelor - Ringjallja ekonomike, fokusi është vendos në lehtësimin e pasojave ekonomike dhe sociale të shkaktuara nga pandemia. Në këtë drejtim Plani i Qeverisë, në kuadër të politikës së jashtme dhe diasporës, parasheh rritjen e rolit të mërgatës në zhvillimin dhe promovimin e vendit. Nëpërmjet krijimit të instrumenteve për investim, do të sigurohet që kapitali i mërgatës sonë të kanalizohet në investime që krijojnë vende pune. Si masë konkrete është paraparë të emetohen bono thesari të dedikuara për mërgatën. Rëndësi të posaçme do t'i kushtohet rrjetëzimit të profesionistëve në mërgatë, ndërtimit të mekanizmave për transferimin e njohurive, ekspertizës, burimeve dhe krijimin e mekanizmave për përfshirje aktive në politikat zhvillimore.

**Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) - 2030** synon: I - Zhvillim të qëndrueshëm ekonomik; II - Zhvillim të barabartë njerëzor; III - Siguri dhe sundim të ligjit; dhe IV - Qeverisje të mirë. Një nga objektivat strategjik për arritjen e forcimit të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, pjesë e Qeverisjes së Mirë, është edhe angazhimi i shtuar i diasporës në promovimin dhe zhvillimin e Kosovës. Një nga elementet e vizionit të Kosovës 2030 është edhe synimi për sigurimin e gjithëpërfshirjes për të gjithë qytetarët e saj dhe të merr parasysh politikat e migrimit e në veçanti të avancoj lidhjet me diasporën si pjesë e pandashme e zhvillimit.

Në kudër të Agjendës Horizontale, është adresuar Migrimi dhe Diaspora dhe është identifikuar si një nga objektivat kryesore që përcjellë zhvillimin e një vendi. Ky objektiv adreson çështjet ndërsektoriale si fuqizimi i marrëdhënieve me diasporën, ruajtja e identitetit kulturor, angazhimi i diasporës në zhvillimin e vendit. Vlen të theksohet se mbështetja e diasporës në formë të remitançave është rritur vazhdimisht, duke e arritur kulmin në vitin 2021 me mbi 1.1 miliardë Euro. Diaspora i ka ndihmuar zhvillimit të vendit në mënyra të ndryshme, përmes investimeve, mundësimit të shkëmbimeve të ndryshme, arsimit, etj.

**Programi i Reformave në Ekonomi (PRE) 2021-2023** është finalizuar në Janar 2021, nën udhëheqjen e ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, si Koordinator Nacional, pas

diskutimit për përmbajtjen e masave, konsistencën e tyre me dokumentet përkatëse strategjike dhe rekomandimet e politikave që kanë rezultuar nga Dialogu Ekonomik dhe Fiskal me Komisionin Evropian.

Bazuar në ndikimin negativ të pandemisë globale Covid-19, strukturën aktuale ekonomike të Kosovës dhe pengesat e shumta për rritjen ekonomike, reformat strukturore janë orientuar në mënyrë të tillë që synojnë rimëkëmbjen e ekonomisë në përgjithësi. Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar për të mbështetur rimëkëmbjen ekonomike dhe për të përmirësuar perspektivat e punësimit. PRE 2021-2023 është një kombinim i:

(1) programit të rimëkëmbjes ekonomike i cili do të synojë të mbështesë rimëkëmbjen ekonomike pas-pandemike,

(2) një politikë fiskale të bazuar në rregulla të orientuara drejt stabilitetit të financave publike dhe brenda hapësirës fiskale në dispozicion, duke mbështetur rritjen ekonomike përmes investimeve kapitale, rritjes së fondeve për zonat prioritare të zhvillimit, dhe

(3) një sërë reformash prioritare strukturore që adresojnë pengesat kryesore të rritjes ekonomike duke mbështetur zhvillimin e sektorëve ekonomik konkurrues dhe duke siguruar që rritja ekonomike është gjithëpërfshirëse dhe e orientuar drejt rritjes së mirëqenies.

Në kuadër të PRE 2021-2023, janë identifikuar prioritetet e reformave që adresojnë pengesat kryesore të rritjes ekonomike dhe konkurrueshmërisë duke i adresuar me 19 Masa.

- Kështu tek Prioriteti II. Bujqësia, Industria dhe Shërbimet, në kuadër të Masës #4: **Rritja e konkurrueshmërisë në industrinë prodhuese**, ndër të tjera synohet të rritet niveli i Investimeve të Huaja Direkte (IHD) dhe të diasporës.
- Tek Prioriteti III. Mjedisi i të bërit biznes dhe ulja e ekonomisë joformale, përmes Masës #7: **Përmirësimi i mjedisit biznesor nëpërmjet zvogëlimit të barrës administrative dhe reformës së inspektimeve**, kjo reformë ndikon direkt në përfitimet e qytetarëve, përfshirë diasporën, e rrjedhimisht edhe në zhvillimin ekonomik të vendit sidomos pas krizës së shkaktuar nga Covid-19.

- Ndërsa tek Prioriteti IV. Mjedisi i të bërit biznes dhe ulja e ekonomisë joformale, **Masa e reformës #8: Themelimi dhe funksionalizimi i Gjykatës Komerciale**, ngritja e sigurisë juridike ndikon edhe në rritjen e investimeve direkte nga kompanitë e huaja dhe diaspora.

Gjatë vitit 2021 është punuar gjithashtu në hartimin e PRE 2022-2024<sup>51</sup>. Pandemia Covid-19 vazhdon të jetë sfidë serioze sociale dhe ekonomike për vendin, duke përkeqësuar rezultatet e varfërisë. Qeveria e Kosovës e ka trajtuar këtë përmes Paketës së Ringjalljes (Emergjente) Ekonomike në 2021. Përveç mbështetjes së drejtpërdrejtë për bizneset, Paketa e Ringjalljes përmban një gamë të gjerë masash që synojnë ata që kanë më shumë nevojë duke ofruar rritje të pensionet (për skemat e pensioneve të zgjedhura), ndihma sociale, mbështetje për pushimin e lehonisë (për nënat e punësuar dhe të papuna), ato që humbën anëtarët e familjes nga Covid-19, etj.

Pagesat për menaxhimin e pandemisë Covid-19, gjatë vitit 2021, janë paraqitur në tabelat në vijim në total, si dhe të ndara në dy pjesë (kodi 00099 dhe 00098):

*Tabela 8: Total pagesat për menaxhimin e pandemisë Covid-19 Pakoja Emergjente (00099) dhe Pakoja e Rimëkëmbjes (00098)*

Kategoria ekonomike	Alokimet buxhetore PRE	Pagesat	Progresi %
Paga dhe shtesa	22,835,686	22,818,887	100%
Mallra dhe shërbime	34,980,292	20,827,710	60%
Shpenzime komunale	47,000	23,894	51%
Subvencione dhe transfere	195,296,335	189,930,516	97%
Shpenzime kapitale	1,132,494	425,680	38%
Gjithsej	254,291,807	234,026,687	92%

*Burimi: MFPT/Thesari i Kosovës*

**Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës**, në kuadër të fushë-veprimtarisë së saj, ka vazhduar me zbatimin e politikave për Diasporën, përkatësisht ka përkrahur themelimin e

<sup>51</sup> PRE 2020-2022 është hartuar aprovuar në Janar 2020. Zbatimi i masave të parapara raportohet në PRE 2021-2023)

strukturave për organizimin e diasporës, me qëllim të krijimit të urave lidhëse ndërmjet vetë pjesëtarëve të Diasporës dhe Institucioneve të Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2021, MPJD ka përkrahur me subvencione, projekte që lidhen me diasporën, po ashtu gjatë këtij viti janë realizuar mbi 25 takime mbi dialogun me mërgatën.

Në bashkëpunim me institucionet relevante në vend (KIESA, ATK, Dogana, Odat Ekonomike, etj.) dhe atyre në Diasporë (si rrjeti i bizneseve të Diasporës), MPJD ka marrë pjesë në një sërë aktiviteteve ekonomike siç janë: Forumet ekonomike, panairot dhe samite të ndryshme.

*Tabela 9: Pjesëmarrja në promovimin e produkteve vendore në bashkëpunim me Diasporën*

Aktiviteti	Data	Institucionet e përfshira në aktivitet	Rezultatet e aktivitetit
<b>Forumi Ekonomik Kosovë-Greqi në formë virtuale</b>	20 prill 2021	MPJD, OEK, ME, KIESA, Shoqata për Energji të Ripërtrishme-Jaha Solar.	Janë krijuar kontakte të bizneseve kosovare me ato greke në fushën e energjisë së ripërtrishme.
<b>Forumi Ekonomik Expo Dubai 2020</b>	Tetor 2021	MINT, MPJD, OEK, MKRS, MASHTI, etj.	DDE si pjesë e grupit punues në EXPO Dubai 2020 merr pjesë në shënimin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës, si dhe sesionin e “Country Business Briefing” në Expo Dubai 2020, së bashku me përfaqësues nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR).
<b>14 vjetori i Pavarësisë së Republikës së Kosovës</b>	17 shkurt 2021	MPJD, Ambasadat dhe Konsullatat e RKS-së, StoneCastle, Kosova Wine.	Ambasadat, Konsullatat e Përgjithshme kanë zhvilluar aktivitete për nder të 14 vjetorit të RKS-së.



Gjatë vitit 2021, Agjencia për Përkrahjen e Investimeve dhe Ndërmarrjeve (KIESA)<sup>52</sup>, e cila vepron në kuadër të **Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë**, në vazhden e aktiviteteve të fushëveprimtarisë së saj, i ka kushtuar një rëndësi të veçantë mbështetjes së bizneseve dhe ambientit të bërit biznes, ku gjithsejtë janë mbështetur mbi 200 biznese në bashkëpunim me Bankën Botërore, ku përkrahja financiare ka qenë kryesisht për blerjen e makinerive prodhuese, iniciativën për fuqizim digjital, certifikimin e produkteve, përkrahjen e grave në biznes si dhe rritjen e eksportit.

Po ashtu vlen të ceket se gjatë vitit 2021 janë bërë investime në zonat ekonomike: Suharekë, Vushtrri, Lipjan, Viti dhe Malishevë, ku në total janë investuar: **698, 574.75 EUR** dhe planifikohen të përgatiten hapësira (parcela) për vendosje të bizneseve të huaja dhe vendore duke pasur gjithnjë parasysh edhe kërkesat e bizneseve të Diasporës. Sa i përket legjislacionit, vlen të ceket se Ligji për Zona Ekonomike dhe Ligji për Investime të Qëndrueshme janë në plotësim-ndryshim dhe së shpejti priten të miratohet. Këto ligje parashohin lehtësira për vendosjen e bizneseve në zonat ekonomike dhe investime më të qasëshme për investitorët e huaj dhe strategjik në përgjithësi. Të gjitha aktivitetet e lartëcekura kanë ndikuar në rritjen e regjistrimit të bizneseve për afër 10% (viti 2020 = 9, 801 biznese të regjistruara, viti 2021 = 10, 659 biznese të regjistruara).

Ministria e Ekonomisë përgjatë vitit 2021 ka vazhduar me hartimin e Strategjisë së Energjisë 2022-2031 i cili dokument synimin kryesor e ka sigurimin e energjisë së besueshme, me kosto të përballueshme, dhe të pastër i cili është thelbësor për zhvillimin ekonomik të vendit dhe mirëqenien sociale të qytetarëve. Viti 2021 është karakterizuar me vartësi të lartë të importit gjatë sezonit të ngrohjes dhe me çmime shumë të larta të importit të energjisë, i cili ka përkeqësuar situatën me furnizim të qëndrueshëm me energji edhe për qytetarët e vendit. Kjo krizë energjetike dëshmoi se sistemi elektroenergetik i Kosovës ka nevojë për një transformim të thellë për t'u bërë më i qëndrueshëm, më i pavarur dhe më fleksibil. Përmes Strategjisë së energjisë synohet që të ullet konsumi përmes eficiencës së energjisë, përmirësimi i besueshmërisë së sistemit, dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme etj. Sipas statistikave, konsumatori më i madh i energjisë në Kosovë është sektori rezidencial, i cili kontribuon me rreth 40% në

---

<sup>52</sup> <http://kiesa.rks-gov.net/>  
<https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,134>


konsumin final të saj, prandaj ulja e konsumit përmes rritjes së efikasitetit të energjisë ndikon në reduktimin e kërkesës për energji i cili është një ndër synimet kryesore të kësaj strategjie.

## 7.3. Statistikat

### 7.3.1. Dërgesat e Emigrantëve (Remitancat)

Remitancat në përgjithësi kanë ndikim të shumëfishtë në aspektet kryesore të zhvillimit në Kosovë. Të hyrat nga dërgesat e emigrantëve janë në rritje si rezultat i trendit të rritjes së emigrimit të rregullt për qëllime të punësimit. Në vitin 2021, remitancat në Kosovë arritën shumën prej 1,153.4 miliardë euro krahasuar me vitin 2020, ku remitancat arritën vlerën 980.1 milionë. Dërgesat e emigrantëve në vitin 2021 kanë pasur pjesëmarrje prej 14.49% në bruto produktin vendor (BPV).

Figura 19: Të hyrat nga remitancat, 2019-2021



Burimi: BQK, 2021


Rreth 73% e dërgesave të emigrantëve gjatë vitit 2021 janë transferuar përmes sistemit financiar, ndërsa pjesa tjetër përfshin dërgesat e emigrantëve në mallra dhe mjete të tjera që transferohen përmes kanaleve joformale. Burimet kryesore të dërgesave të emigrantëve vazhdojnë të jenë nga

Gjermania me 39.2% dhe Zvicra me 18.9% të totalit të dërgesave të pranuar në Kosovë duke pasuar me SHBA-të me 7.2%, Austria me 4.4% dhe Italia me 4.2%, dhe Franca me 3.9%.

### 7.3.2. Investimet e Huaja Direkte

Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë për vitin 2021 arrijnë vlerën prej 420.7 milionë euro, apo 23% më shumë sesa në vitin paraprak. Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur trendi i IHD-ve në Kosovë gjatë periudhës 2016-2021.

Figura 20: Investimet e huaja direkte në Kosovë të shprehura në miliona euro dhe si përqindje e BPV-së, 2019-2021



Burimi: BQK, 2021


Sektorët që kanë pasur trend pozitiv krahasuar me vitin paraprak dhe kanë ndikuar në rritjen e investimeve gjatë vitit 2021 janë sektorët e patundshmërisë, financiar, sektori i informimit dhe komunikimit, si dhe ai i ndërtimit. Pjesëmarrja e patundshmërisë në gjithsej investimet direkte në Kosovë në vitin 2021 ishte 91.3%, (384 milion euro) aktivitetet financiare me 5.9% (24.6 milion euro), informimit dhe komunikimit me 4.1% (17.3 milion euro), dhe ai i ndërtimit me 3.86% (16.7 milion euro).

### 7.3.3. Shërbimet e Udhëtimit të Vizitorëve në Kosovë / Turizmi i Diasporës në Kosovë

Kosova gëzon turizëm të konsiderueshëm nga diaspora, veçanërisht gjatë pushimeve sezonale të verës dhe dimrit. Të hyrat nga shërbimet e udhëtimit janë rritur vazhdimisht që nga viti 2013 duke arritur në 1,321.4 milion euro në vitin 2019. Gjatë vitit 2020 për arsye të pandemisë dhe mbylljes totale për disa muaj, vlera e turizmit ka rënë për 52.5%, duke shënuar vlerën 628.0 milion euro. Ndërsa pas heqjes së kufizimeve të pandemisë në vitin 2021, vlera e turizmit është rritur për 82% dhe ka arritur në shumën prej 1,490.1 miliardë euro.

Pjesa dominuese e të ardhurave të kësaj kategorie, rreth 90%, i atribuohet diasporës.


Figura 21: Shërbimet e udhëtimit të vizitorëve, 2019-2021



Burimi: BQK, 2021

Rëndësia e diasporës mund të shihet edhe nga përqindja e pjesëmarrjes në bruto produktin vendor ku remitancat përbëjnë rreth 14.5% të BPV-së, shërbimet e udhëtimit të diasporës përbëjnë 17.23% dhe nga përqindja e pjesëmarrjes së IHD-ve në patundshmëri me 4.34%, siç është paraqitur në Figurat 14, 15 dhe 16. Duke pasur parasysh se shumica e këtyre tre komponentëve përbën rreth 36% të bruto produktit vendor, të hyrat përkatësisht nga migrimi janë faktor i rëndësishëm për të mundësuar konsumin e brendshëm të vendit (konsumi plus investimet) dhe për të ndihmuar në ngritje të prodhimit vendor.

Figura 22: Të hyrat e përgjithshme nga Diaspora



Burimi: BQK, 2021

## 8. Azili

### 8.1. Autoritetet Shtetërore Përgjegjëse

Divizioni për Azil në kuadër të DSHAM/MPB është autoriteti përgjegjës për zhvillimin e procedurës së azilit. Qendra për Azil është përgjegjëse për pranimin dhe akomodimin e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare gjatë procedurës së përcaktimit të statusit. Komisioni Kombëtar për Refugjatë (KKR) është organ kompetent në shkallë të dytë për shqyrtimin e ankesave të drejtuara kundër vendimeve të shkallës së parë.

Policia Kufitare e PK-së është përgjegjëse në procedurën fillestare, e cila përfshin parashtrimin e aplikacioneve, intervistën fillestare, marrjen e shenjave të gishtërinjve dhe fotografive dhe transferimin e aplikuesve në Qendrën për Azil.

Qendra për Azil është përgjegjëse: për pranimin, regjistrimin, akomodimin, pajisjen e aplikuesve me dokumente personale përgjatë procedurës së kërkimit të azilit. Aktivitetet e pranimit dhe akomodimit shfrytëzohen për t'ju dhënë mjetet dhe kujdesin e nevojshëm për jetesë atyre që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare. Mjetet e jetesës mbulojnë akomodimin, ushqimin, veshmbathjet, pakot higjienike dhe format tjera të ndihmës fizike, ndërkohë që kujdesi iu referohet ndihmës së natyrës mjekësore, sociale, psikologjike, edukuese, juridike, kulturore, si dhe çështje tjera të rëndësishme lidhur më punën e Qendrës për Azil.

### 8.2. Politikat dhe Korniza Ligjore

Gjatë vitit 2021, ka filluar procesi i hartimit të disa akteve nënligjore dhe dokumente udhëzuese në fushën e azilit, si në vijim:

- Miratimi i Udhëzuesit për Vlerësimin dhe Përcaktimin e Interesit më të mirë të Fëmijëve Aplikues për Mbrojtje Ndërkombëtare, Refugjatë dhe Migrantë në Kosovë, është miratuar nga Sekretarja e Përgjithshme e MPB-së, me datën 28.09.2021;

- Plani i Reagimit për Menaxhimin e Fluksit të Mundshëm të Migrantëve, Refugjatëve dhe Aplikuesve, është miratuar në Qeveri me Vendimin Nr.14/15 te datës 23.12.2021<sup>53</sup>.

Sa i përket masave kundër pandemisë Covid-19, Qendra e Azilit ka ndërmarrë masa të nevojshme komfort vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me qëllim të parandalimit të përhapjes së virusit Covid-19. Këto masa janë përkrahur nga institucionet e specializuara vendore si IKSHPK dhe MSH dhe organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare si UNHCR, IOM, JRS, UNICEF, EXBS, ICITAP dhe GIZ.

Këshillimet psikologjike dhe ligjore janë mbajtur në formatin "Online" për të shmangur tubimet masive dhe për t'iu përmbajtur distancës sociale siç ishte këshilluar nga Ministria e Shëndetësisë. Gjithashtu edhe procesi arsimor është mbajtur në formatin 'online' për fëmijët aplikues për mbrojtje ndërkombëtare të akomoduar në objektet e Qendrës për Azil.

## 8.3. Statistikat

### 8.3.1. Azilkërkuesit në Kosovë

Numri i azilkërkuesve në Kosovë gjatë vitit 2021 ishte 578, duke shënuar rënie prej 59% në krahasim me vitin paraprak 2020 (1,409).


Sipas vendit të origjinës, azilkërkuesit ishin nga: Siria 179 (31%), Maroku 147 (25.4%), Algjeria 66 (11.4%) dhe shtetet e tjera 186 (32%).

Grup-mosha më e përfaqësuar në mesin e azilkërkuesve është 18-34 vjeç me 436 (75%), 35-64 vjeç me 83 (14.3%), 0-13 vjeç me 33 (5.7%), 14-17 vjeç me 25 (4.3%), dhe grup-mosha 65+ me 1 person.

---

<sup>53</sup> I njëjti si tek kapitulli 'Migrimi i Parregullt'

Figura 23: Azilkërkuesit në Kosovë sipas grup-moshës, 2019-2021



Burimi: DSHAM/MPB

Nga numri i përgjithshëm i aplikueseve për mbrojtje ndërkombëtare për vitin 2021, persona të rritur ishin 525 (91%), fëmijë 34 (6%) dhe 19 (3.2%) fëmijë të pashoqëruar.

Sipas gjinisë, dominon gjinia mashkullore me 535 (92.5%) përderisa gjinia femërore përfaqësohet me 43 (7.4%).

Sipas statusit të vendimeve, gjatë vitit 2021 u është ndërprerë procedura 472 (89.4%) aplikuesëve, ndërprerje vullnetare të procedurës ishin 23 (3.9%), vendime lidhur me njohjen e statusit të refugjatit 16 (2.8%), refuzim sipas procedurës së përshpejtuar 6 (1%), vendim refuzimi 4 (0.7%) si dhe vendime për mbrojtje plotësuese 16 (2.8%).

Sipas këtyre të dhënave stoku më i madh i kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare rezulton në ndërprerje të procedurës sepse aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare e lëshojnë territorin e Republikës së Kosovës, derisa janë ende në procedurë të shqyrtimit të aplikacionit për mbrojtje ndërkombëtare.




Azilkërkuesve u janë ofruar shërbimet shëndetësore falas, ndihma juridike dhe administrative, asistencë sociale dhe psikologjike, shujta ditore, veshmbathje, pako higjienike dhe forma të tjera të ndihmës fizike. Gjithsej janë ofruar 1,257 shërbime mjekësore, 530 shërbime juridike falas, 575 këshilla sociale, 109 shërbime për mbështetje psikologjike, dhe 610 orë kurse të gjuhës shqipe, 110 orë kurse të kompjuterit. Gjithashtu gjatë vitit 2021 janë ofruar shërbime të akomodimit dhe ushqimit për 578 persona.

### 8.3.2 Azilkërkuesit Kosovarë në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen

Në vitin 2021, numri i aplikuesve Kosovarë për herë të parë për azil<sup>54</sup>, në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Shengen, ishte 1.640 persona. Krahasuar me numrin e përgjithshëm të aplikuesve për azil (2,390 persona), ishte për (750 persona ose 45%) më i ulët. Të dhënat për numrin e aplikuesve për herë të parë në vitin 2021, tregojnë se kishte ngritje prej rreth 4%, krahasuar me vitin 2020 (1,575 persona).

Figura 24: Azilkërkuesit kosovarë në shtetet e BE-së dhe të zonës Shengen, 2019-2021



Burimi: Eurostat

54 Aplikantët për herë të parë (për azil) nënkupton një person që ka paraqitur një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare ose që është përfshirë në këtë kërkesë si anëtar i familjes, për herë të parë. Kërkesat e dorëzuara nga persona të cilët më pas konstatohen se janë subjekt i një procedure të Dublinit përfshihen në statistikat për aplikantët për herë të parë për azil nëse këta persona janë gjithashtu subjekt i kërkesës së parë për azil. Një person mund të regjistrohet si aplikant për herë të parë vetëm nëse ai ose ajo nuk ka aplikuar kurrë për mbrojtje ndërkombëtare në vendin raportues në të kaluarën, pavarësisht nga fakti se ai ose ajo rezulton se ka aplikuar në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian.

Aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare për herë të parë me shtetësi kosovare, përbënin 0.3% të numrit të përgjithshëm të të gjithë aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare për herë të parë në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Shengen (550,750).

Të dhënat sipas gjinisë nuk dallojnë nga viti paraprak, meshkujt përbënin rreth dy të tretat 66%, të numrit të përgjithshëm të aplikuesve për herë të parë në vitin 2021, në krahasim me gjininë femërore e cila përbënte 34%.

Sipas moshës, përqindja më e madhe e aplikuesve për herë të parë ishin ndërmjet moshës 18-34 vjeçare me 760 (46%), mosha më pak se 14 vjeç (të mitur) me 440 (27%), mosha nga 35-64 vjeç me 350 (21%), mosha 14-17 vjeç ishte më pak e përfaqësuar me 80 (5%).

Destinacioni i aplikuesve për herë të parë të shtetasve kosovarë gjatë vitit 2021, pësoi disa ndryshime në renditje të shteteve krahasuar me vitin e kaluar. Franca me 855 (52%), aplikues të regjistruar, mbetet destinacioni kryesor, ashtu sikurse vitin e kaluar. Destinacioni i radhës ishte Italia 280 (17%), Gjermania 215 (13%), Belgjika 70 (4%), Sllovenia 65 (4%) dhe shtetet tjera me nën 10%.

### **Aplikimi i mëvonshëm**

Duke filluar nga viti 2021, Eurostat për herë të parë mbledh statistika për aplikuesit e mëvonshëm (persona që riaplikuan për azil pasi ishte marrë një vendim për një aplikim të mëparshëm)<sup>55</sup>.

Sipas të dhënave të disponueshme, numri i shtetasve kosovarë që kanë bërë një aplikim të tillë, ishte 715 aplikues të mëvonshëm për azil, të regjistruar në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen në vitin 2021. Vendet kryesore të aplikimit ishin Franca me 355 (50%) aplikues, Gjermania me 225 (31.4%) aplikues, Belgjika me 95 (13.2%) aplikues dhe vendet tjera me 40 (5.6%) aplikues.

---

<sup>55</sup> **Aplikimi i mëvonshëm** - nënkupton një kërkesë të mëtejshme për mbrojtje ndërkombëtare e bërë pasi është marrë një vendim përfundimtar për një aplikim të mëparshëm, duke përfshirë rastet kur aplikanti ka tërhequr në mënyrë eksplicite aplikimin e tij ose të saj dhe rastet kur autoriteti përcaktues ka refuzuar një kërkesë pas tërheqjes së nënkuptuar të tij në përputhje me Neni 2, q) dhe nenin 28 (1) të DIREKTIVËS 2013/32/BE TË PARLAMENTIT DHE TË KËSHILLIT EVROPIAN e datës 26 qershor 2013 mbi procedurat e përbashkëta për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare.

## **Kërkesat për azil në Mbretërinë e Bashkuar**<sup>56</sup>

Të dhënat për numrin e azilkërkuesve në Mbretërinë e Bashkuar që nga viti 2020, nuk publikohen në Eurostat.

Numri i shtetasve kosovarë që bënë një kërkesë për azil në Mbretërinë e Bashkuar, gjatë vitit 2021, ishte gjithsej 20 persona, në krahasim me vitin paraprak 2020 (15) u rrit për 25%, kurse numri i shtetasve kosovarë që kanë pranuar mbështetje gjatë vitit 2021 ishte rreth 30 persona, që në krahasim me vitin 2020 (rreth 37 persona) ishte më i vogël për 23.3%.

Sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se kryesisht meshkujt përbënin rreth 85%, të atyre që kishin bërë një kërkesë për azil në Mbretërinë e Bashkuar në krahasim me gjininë femrore e cila përbënte 15%. Sipas grup-moshës, kryeson ajo me 30-49 vjeç me 65%, 18-29 vjeç me 30% dhe nën moshën 18 vjeç me 5%.

---

<sup>56</sup> <https://www.google.com/search?q=Asylum+applications%2C+2001+Q1+to+2021+Q4+-+dataset&dq=Asylum+applications%2C+2001+Q1+to+2021+Q4+-+dataset&aq=chrome..69i57j69i60l3.1910j0j15&sourceid=chrome&ie=UTF-8,% 25.05.2022>

## 9. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

### 9.1. Përfundimet

Gjatë vitit 2021 kanë vazhduar masat kufizuese që kanë patur për qëllim menaxhimin e situatës me pandeminë Covid-19 por këto masa janë lehtësuar në aspektin e lëvizjeve migratore, si dhe në aspektin e funksionimit të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë së vendit. Si rezultat i lehtësimit të këtyre masave në Republikën e Kosovës dhe në shtetet tjera në rajon dhe në Bashkimin Evropian, statistikata e publikuara nga ASK konfirmojnë një numër të madh të qytetarëve tanë që kanë emigruar gjatë vitit 2021, kryesisht në shtetet e BE-së. Ky trend në rritje të emigrimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës në mënyrë të rregullt rezulton edhe me rënien rekorde të emigrimit të parregullt. Ky trend në rritje mund ti atribuohet edhe rimëkëmbjes ekonomike në shtetet e BE-së pas lehtësimit të masave anti-Covid dhe kërkesës për fuqi punëtore në veçanti në mesin e migrantëve.

Imigrimi i të huajve në Republikën e Kosovës shënoi një trend në rënie gjatë vitit 2021, në veçanti imigrimi i parregullt. Edhe përkundër këtij trendi në rënie, institucionet e Republikës së Kosovës kanë vazhduar me zgjerimin e kapaciteteve pritëse dhe akomoduese për imigrantët e parregullt si dhe është funksionalizuar Qendra e Përkohshme e Pritjes për Migrantë.

Kontributi i diasporës në zhvillimin socio-ekonomik të vendit mbetet i pazëvendësueshëm, dhe viti 2021 shënon një ngritje rekorde të remitencave, kategorisë së turizmit të diaporës si dhe IHD-ve që shumica vlerësohet se investohen nga pjesëtarët tanë të diasporës. Ky trend në rritje i kontributit të diasporës reflekton edhe nevojën e zhvillimit të politikave që kanë për qëllim fuqizimin e urave lidhëse në mes të institucioneve të Republikës së Kosovës, komunitetit në përgjithësi dhe mekanizmave të ndryshëm që përfaqësojnë diasporën dhe interesat e tyre.

## 9.2. Rekomandimet

1. Harmonizimi i bazave të të dhënave vendore në fushën e migrimit me standardet dhe rregulloret e BE-së dhe Eurostat lidhur me statistikat.
2. Lejeqëndrimet për qëllime punësimi të lëshohen pas marrjes së aprovimit nga APRK, bazuar në analizat e tregut të punës. Ligji për të Huaj i cili do të rishikohet duhet të krijoj bazën ligjore për adresimin e këtij rekomandimi.
3. Shqyrtimi i mundësive për negociim dhe nënshkrim të marrëveshjeve bilaterale ose memorandumeve të mirëkuptimit për migrim për qëllime punësimi me shtetet e rajonit, si dhe me shtetet anëtare të BE-së, në veçanti ku janë të koncentruar emigrantët me origjinë nga Kosova.
4. Zbatimi i marrëveshjes së mobilitetit për punë të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, në kuadër të zbatimit të politikave rajonale dhe lehtësimit të mobilitetit për punë palët angazhohen të punojnë me institucionet përkatëse në lehtësimin e procedurave administrative për qasje të lirë në tregun e punës.
5. Lehtësimi i kriterëve për regjistrimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës për personat e ripranuar përmes ndryshimeve ligjore.
6. Avancimi i bashkëpunimit ndër-institucional në aspekt të zbatimit të politikave të ripranimit.
7. Hartimi i politikave që kanë për qëllim promovimin e dërgesave (remitencave) përmes kanaleve formale, duke synuar uljen e kostos së transferit.
8. Hartimi i politikave që kanë për qëllim kthimin e kuadrove nga diaspora dhe angazhimin e tyre në sektorë të ndryshëm publik dhe jo-publik.
9. Avancimi i mëtejme i sistemit të integritit të të huajve.
10. Avancimi i sistemit të kthimit të imigrantëve me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshirë bashkëpunimin rajonal dhe me mekanizmat e BE-së.
11. Inicimi i nismave ligjore për negociimin e marrëveshjeve për ripranim me vendet e origjinës së migrantëve.

12. Promovimi i politikave për kthim vullnetar, në veçanti përmes zbatimit të marrëveshjes në mes të MPB-së dhe IOM-it.
13. Avancimi i mekanizmave për të menaxhuar flukset e përziera të migracionit.
14. Përditësimi në baza vjetore, apo sipas nevojës, të Planit të Reagimit për menaxhimin e flukseve me migrantë, refugjatë dhe aplikues për mbrojtje ndërkombëtare.
15. Avancimi dhe integrimi i sistemeve informative që mbajnë të dhëna të migrimit.
16. Monitorimi dhe vlerësimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Migrimit 2021-2025 dhe politikave tjera të ndërlidhur me fushën e migrimit.
17. Rishikimi i Planit të Veprimit 2021-2023 të Strategjisë për Migrim.